

Ana tjetër e medaljes

## PROTEKTORPAVARËSI NË AHTISARISTAN

**Kemi një protektorpaavarësi, që nuk është as protektorat tamam, por as pavarësi tamam. Prezenca ndërkombëtare quhet e lehtë, ndërsa është vendimmarrëse, kemi një autonomi të serbëve që quhet decentralizim dhe kemi një prezencë të Serbisë në Kosovë, e cila është faktike, por është e maskuar si “sponsorizim”. Me një fjalë kemi një mishmash.**

Milazim KRASNIQI



Drafti që solli në Prishtinë Marti Ahtisari vazhdon të komentohet e të vlerësohet pothuajse nga të gjithë dhe me të njëjtin pasion me të cilin komentohen e vlerësohen ndeshjet e futbollit. E veçanta e këtyre debateve është se duket që të gjithë pjesëmarrësit në debate, në të vërtetë kanë edhe të drejtë: edhe ata që janë në favor të këtij draftdokumenti e edhe ata që janë kundër tij. Por, të gjithë kanë të drejtë vetëm pjesërisht. Kjo për shkak të vetë dokumentit të Marti Ahtisari, i cili është i pjesërishtëm dhe ofron zgjidhje të pjesërishtme. Prandaj, ata që kërkojnë anën e mirë të tij, e gjejnë, dhe ata që e kërkojnë anën e dobët të tij, e gjejnë me lehtësi.

A është kjo mjeshtri diplomatike e radhës e ndërmjetësuesit veteran nga Finlanda, apo është diçka më shumë?

Kriza e Kosovës është së paku njëzet e katër vjet më e vjetër se sa mosha edhe ashtu mjaft e shtyrë e Marti Ahtisarit. Kjo krizë shqiptaro-serbe gati njëshekullore, ka njohur ashpërsime dhe zbutje, por kurrë nuk është shuar plotësisht. Shqiptarët dhe serbët kanë aspirata të kundërta në të njëjtën tokë. Serbët që nga tetori i vitit 1912, kur kanë hyrë në Kosovë si agresor, janë munduar ta zgjidhin në mënyrën e tyre të preferuar, me vrasje masive, me dëbime të dhunshme të shqiptarëve, me kolonizime me sllavë dhe me spastrime etnike. Edhe përkundër pasojave të rënda që u kanë shkaktuar shqiptarëve, ata nuk kanë pasur sukses ta ndryshojnë epilogun demografik që ka rezervuar për këtë vend nëna shqiptare (po t'i referohemi shqetësimit të vjetër të Vasa Çubrilloviqit). Ndërsa, shqiptarët kanë organizuar kundërpërgjigjet e veta të herë

pas hershme me rebelime e madje edhe më një luftë të armatosur, por nuk kanë arritur t'i mundin serbët. U është dashtë ndihma e komunitetit ndërkombëtar. Rrjedhimisht, komuniteti ndërkombëtar që intervenoi në vitin 1999, tash tetë vjet është ndërmjetësi dhe arbitri i këtij konflikti të përgjakshëm, i cili vetëm falë komunitetit ndërkombëtar, mbahet i fashitur. Po të ndodhte tërheqja e prezencës ushtarake dhe politike nga Kosova, konflikti do të riniste menjëherë dhe Kosova do të shndërrohej në kasaphanë, duke e futur në jostabilitet mbarë Ballkanin Perëndimor. Prandaj, zgjidhja e pjesërishtme që ka skicuar Marti Ahtisari, nuk është një “gjetje diplomatike” por është vetëm mbarështrim i një ekuacioni të rëndë, sipas të cilit duhet të gjendet zgjidhja graduale për këto të njohura: Kosova nuk pranon në asnjë mënyrë që të mbahet e lidhur me Serbinë, Serbia në asnjë mënyrë nuk e pranon pavarësinë e Kosovës dhe komuniteti ndërkombëtar në asnjë mënyrë nuk dëshiron që rajoni të rikthehet në gjendjen e luftërave të përgjakshme. Prej kësaj rezulton se Kosova është e vendosur që të ndahet definitivisht nga Serbia, por nuk ka qenë e aftë të çlirohet vetë dhe në këtë fazë as nuk është e aftë të funksionojë si shtet i pavarur e t'i integrojë paqësisht serbët, Serbia është e vendosur ta mbajë Kosovën, por kjo është e pamundur kur ka një qëndrim të sedimentuar armiqësor ndaj shqiptarëve dhe as që ka një ofertë normale për ta. Për këto shkaqe, Marti Ahtisari e ka hartuar një dokument që është më i vështirë për t'u zbatuar, se sa ngasja në atë moshë të tij e biçikletës mbi një litër të kacavarur.

Por, nuk duhet lënë anash në tërë këtë kontekst edhe një fakt: faturën e rëndë që po paguan Kosova me këtë status të ndërlikuar e të paqartë, e ka ngarkuar edhe paaftësia e manifestuar në këto tetë vjet të jetës në liri, për ta ngritur një shoqëri tolerante, demokratike dhe

efikase.

Korrupsioni në qeveri, banditizmi politik, familjarizimi, zgjedhja sipas kriterëve klanore, kanë krijuar një administratë të paaftë për të bërë shtet. Nga ana tjetër, dhuna e shfrenuar e marsit 2004 kundër serbëve dhe objekteve të tyre fetare, e ka kthyer pozitën e shqiptarëve nga viktima në agresor. Kjo nuk duhet të fshihet po duhet të mbahet mend mirë, për të mos u përsëritur më kurrë. Fatkeqësisht, harresa në Kosovë di të jetë “element patriotik”: në foltoren e Kuvendit të Kosovës më 9 shkurt të këtij viti, një anëtare e kabinetit qeveritar, tha se nuk ka pasur fare përndjekje të serbëve e të romëve. Ndërsa, përndjekja dhe dhuna e marsit 2004, e cila ka ndodhur vërtet, jo vetëm që nuk i integroi serbët e Kosovës, po përkundrazi e legjitimoi diversionin e tyre ndaj pavarësisë së Kosovës, si “vetëmbrojtje nga dhunuesit shqiptarë”. Pra, për shkak të barrës historike që mbartë në vete konflikti serbo-shqiptar në Kosovë dhe për shkak të gabimeve fatale që ka bërë elita politike shqiptare në vitet 1999-2007, po edhe shoqëria shqiptare, kemi një faturë që nuk është lehtë të kapërdihet, po të shikohet në tërësinë e saj. Kemi një protektorpaavarësi, që nuk është as protektorat tamam, por as pavarësi tamam. Prezenca ndërkombëtare quhet e lehtë, ndërsa është vendimmarrëse, kemi një autonomi të serbëve që quhet decentralizim dhe kemi një prezencë të Serbisë në Kosovë, e cila është faktike, por është e maskuar si “sponsorizim”. Me një fjalë kemi një mishmash.

Kemi një gjellë që disave u shijon nga pak, ndërsa disave u ngjallë të vjellat. Thjesht, duhet ta kuptojmë: kemi një Ahtisaristan, si alternativë të Dardanisë dhe “Stara Serbisë”, në njërin anë dhe të budallakive tona të viteve të fundit në anën tjetër. Na pëlqeu s'na pëlqeu, s'kemi nga t'ia mbajmë, veçse të mësohemi me shijen e saj.

Vështrim

## KOSOVA DHE DIPLOMACIA E SHQIPËRISË

**Në dhjetor të vitit 2005 ministri i jashtëm Besnik Mustafaj u vu në qendër të kritikave publike për tezën e tij të “pavarësisë së kushtëzuar” për Kosovën. Ajo që kemi sot përpara nga i dërguari i posaçëm finlandez Ahtisaari është edhe më pak se kaq. Dhe të gjithë jemi të kënaqur...**

Alban BALA

Në dhjetor të vitit 2005 ministri i jashtëm Besnik Mustafaj u vu në qendër të kritikave publike për tezën e tij të “pavarësisë së kushtëzuar” për Kosovën. Ajo që kemi sot përpara nga i dërguari i posaçëm finlandez Ahtisaari është edhe më pak se kaq. Dhe të gjithë jemi të kënaqur...

Presidenti Ahtisaari dhe bashkësia ndërkombëtare pas tij mbështesin një

“mëvetësi të mbikëqyrrur”, por të njohur në rrafshin ndërkombëtar. Sepse një shtet anëtar i Organizatës së Kombeve të Bashkuara është de facto edhe i pavarur. Mbështetja e Shqipërisë ndaj këtij propozimi, që pritet të zyrtarizohet brenda verës 2007 me votën e Këshillit të Sigurimit, është një veprim i padiskutueshëm.

Ajo çfarë realisht shqetëson kosovarët është decentralizimi dhe aty Tirana e ka pak vështirë të përzihet. Albin Kurti dhe terminologjia e tij maoiste për rikolonizim të Kosovës rrezikon të gjejë mbështetës, sidomos në terrenin e brishtë social kosovar, ku varfëria pritet të thellohet. Vizionet konfuzë të ndonjë media të rëndësishme veçse i shërbejnë këtij rezultati.

Por as New York Times dhe as serbofilia e ndonjë editorialisti nuk mund të prodhojë më centrifuga të përgjakshme konfliktesh në Ballkan. Çdo ndarje e Kosovës do të çonte në ndarjen e Republikës Serbska nga Bosnja, të Iliriadës shqiptare nga Maqedonia, ndarjen e Preshevës, Bujanovcit e Medvegjës nga Serbia, të Plavës, Gucisë, Ulqinit e Tuzit nga Mali i Zi, e kështu me radhë.

Në momentin e tanishëm, çdo kërkesë që e zhvendos fokusin nga paketa e z.Ahtisaari nuk prodhon tjetër veçse një konflikt të ri, më të madh.

Çfarë mund të ofrojë Shqipëria për Kosovën?

Së pari, këshillën e urtë dhe distancën e duhur si deri më tani. Së dyti, një diplomaci më agresive në rrafshet e zbrazëta të bashkëpunimit ekonomik. Së treti, përmasën e vërtetë të një tregu rajonal me karakter kombëtar.

Projekti i nisur i ndërtimit të rrugës Durrës - Morinë është vetëm fillimi i një procesi që duhet të prodhojë suksesin e kërkuar.

Ende Shqipëria shërben si trampolinë për një grup mallrash që më tej nga Kosova duhet të kontrabandohen në vende të tjera. Shqipëria me kompanitë e saj, deri më sot, ka shërbyer si kredencial nacional për hytjen në Kosovë të biznesit të madh grek, sidomos në fushën e hidrokarbureve, por jo vetëm aty.

Nëse ka një fushë ende të pa-eksploruar në bashkëpunimin mes palëve, kjo është sfera e energjisë. Një sistem i integruar dhe i balancuar i gjenerimit të energjisë mes dy vendeve do të prodhonte



qëndrueshmëri zhvillimore dhe shanse reale për të ri-formatuar modelet ekonomike, duke i orientuar drejt prodhimit. Rivlerësimi i sistemit aktual të transmetimit në përputhje me perspekt-



ivat zhvillimore brenda kuadrit të planifikuar të investimeve në këtë fushë përbën gjithashtu një çështje prioritare. Nuk mund të presim që këto projekte perspektive të na i bëjnë donatorët. Aq më pak mund të lëvizim në pista të shkëputura interesash zhvillimore. Statusi i Kosovës prodhon detyrimisht një ndërvarësi shumë më konkrete mes dy palëve qeverisëse ndër shqiptarët.

E parë në këtë optikë, ka qenë e pakuptimtë përpjekja e Tiranës zyrtare për të tërhequr në Shqipëri Gazprom-in, i cili ishte shumë i qartë në durimin e tij për të hyrë në Evropë përmes Serbisë, sapo asaj t'i hapet paksa rruga e ri-integrimit. Për më tepër, kjo ndodhi në kohën kur ndaj Gazprom-it kishte një betejë politike të hapur në krejt frontin perëndimor të shteteve, për të reduktuar varësinë e BE-së nga furnizimi me gaz rus. Ftesa e Shqipërisë ndaj Gazprom-it, në këtë rast, shkonte kundër direktivave politike evropiane dhe më gjerësisht atlantike në energjetikë.

Tani sërish, procesi i privatizimit të tre rafinerive të naftës në Shqipëri nuk duhet



të rrezikohet nga mungesa e vizionit, edhe pse disa palë mund të pretendojnë se e kontrollojnë këtë sektor strategjik në thuajse krejt Ballkanin.

Çdo gjykim për të balancuar interesat politike në Kosovë, me lëshime ekonomike në Shqipëri, do të ishte në rastin e Tiranës një gabim. Kjo qasje do të shkatërronte shanset për një treg shqiptar gradualisht të unifikueshëm.

Sistemi financiar është po ashtu një prej distancave që duhet të shkurtrohet kur është fjala për bashkëpunim me Kosovën. Në të dy vendet tona sot veprojnë një numër operatorësh të përbashkët duke përfshirë Reiffaisen Bank, Procredit Bank, një numër i madh bankash greke, etj. Po ashtu shoqëritë kryesore shqiptare të sigurimeve janë aktive në të dy anët e kufirit. Për këtë shkak, gjykoj se sot është koha për t'u marrë në konsideratë një sugjerim i herët i z. Selami Xhepa sot këshilltar ekonomik pranë kryeministrit-për euroizimin e monedhës kombëtare në Shqipëri. Kjo do të përshpejtonte edhe integrimin e ekonomisë shqiptare në krejt hapësirën ekonomike të rajonit.

Po ashtu liberalizimi i shërbimit ajror që lidh Tiranën me Prishtinën, përkrah zhvillimit të terminaleve të reja ajrore

pisllëqet që bëjnë kosovarët ju mvishen shqiptarëve” dhe kërkoi nga partnerët evropianë që të dallonin mirë diferencën. Ky qëndrim, që e habiti jo pak belgun e mësuar me antagonizmin franko-flamand të Belgjikës, mbetet një mësim i madh për fatin e përbashkët.

Edhe pse në dy shtete të dallueshme, shqiptarët e të dy anëve të kufirit do të vazhdojnë të perceptohen ngjashmërisht falë përkatësisë kombëtare. Fati i përbashkët do të shprehet së pari në imazhin e përbashkët që shqiptarët do të ndërtojnë prej sot e në vijim.

E thënë thjesht, çdo përpjekje për përmirësimin e imazhit të Kosovës do të jetë për Shqipërinë një investim në ngritjen e imazhit të saj. Dhe çdo cenim imazhi që do të prodhohet në Kosovë, do të rëndojë mbi rudhat e thella të fytyrës së përbashkët të shqiptarëve.

Asnjë përpjekje për të promovuar tregun shqiptar në botë, në asnjë rrethanë nuk mund ta përjashtojë më Kosovën. Kompanitë shqiptare nuk kanë thjesht 3 milion konsumatorë, por të paktën 6 milion të tillë. Dhe çdo investitor i huaj që arrin në Tiranë, e ka këtë vetëdije.

Ndërtimi i markës shqiptare në tregun global do të kërkojë patjetër përfshirjen



**TRANSPARENCY  
INTERNATIONAL**

the coalition against corruption

lokale, do të ishte një ndihmë në rritjen e shpejtësisë së qarkullimit të njerëzve, çka prodhon rritjen e volumit në shkëmbimin e mallrave dhe kulturës.

I njëjti proces duhet nxitur edhe në Prishtinë. Qysh në kohën e qeverisë së z. Bajram Rexhepi, ish-ministri i transporteve z. Zef Morina e ka hedhur idenë e ndërtimit me koncesion të aeroportit të Gjakovës.

I gjithë ky proces kërkon paralelisht thellimin e betejës ndaj fenomeneve kriminale në ekonomi dhe luftën kundër informalitetit.

Pavarësia e Kosovës pa këtë proces mbështetës për rritjen ekonomike të saj, do të ishte vetëm një mjerim zhgënjyes.

Imazhi i Përbashkët si Fat i Përbashkët Një ish-ministër socialist rendi, ndërsa nënshkruante rreth vitit 2002 një Marrëveshje Ripranimi me homologun e tij belg, ju tha gazetarëve se “shpesh

në suazat e analizës së shanseve dhe riskut edhe të asaj që ofron Kosova.

Prej sot Tirana ka motivimin e plotë që ta shohë ndërtimin e tregut të hapur rajonal si një rrugë të materializimit të programit të saj kombëtar të zhvillimit, përtej premisë formale të përafrimit të saj me BE-në.

Por është shumë e rëndësishme që ky proces të mos i japë Prishtinës atë që drejtori i Transparency International, Kreshnik Spahiu e quajti rreth një vit më parë, si fenomeni i “Sundimit të Karteleve Tregtare” dhe që e kanë varur ekonominë e vendit 85% tek importet.

Nëse mbijeton dhe shtrihet si i tillë, ky model anti-ekonomik vetëm do ta varfërojë më thellë arealin shqiptar të Ballkanit, duke na kthyer përfundimisht në konsumatorë perfektë, që kur-e-kur arrijnë të shesin krahun e lirë të punës për një copë bukë thatë.

Procesi i Decentralizimit**KËRKESAT SERBE PËR KANTONIZIM**

**Decentralizimi i pushtetit në Kosovë, nuk do të fillojë pa mënjanimin e të gjitha strukturave paralele. Mirëpo kjo nuk po ndodh sot e sa muaj pas deklaratave të zyrtarëve ndërkombëtarë. Me decentralizim, strukturat paralele jo vetëm që nuk po shuhen, por ato vetëm sa po forcohen tash me bisedimet e Vjenës, duke kërkuar lidhje vertikale me Beogradin.**

Islam PEPAJ

Qysh në fillim të shtjellimit të decentralizimit si proces, duhet të përmenden disa nga përparësitë që ofron decentralizimi, sepse nuk mund të kundërshtohet decentralizimi si proces, për shkak të shumë përparësive që ka dhe ato janë në "shpërndarjen e përgjegjësive në më shumë shkallë, afrimin e shërbimeve qytetarit, shkurtimin e rrugës së komunikimit të pushtetit me qytetarin,

Përparësitë të cilat i posedon decentralizimi si proces në rastin e Kosovës, nuk janë të përshtatshme. E them këtë për arsye se Kosova ende nuk posedon centralizimin e plotë. E meqenëse nuk ka centralizim, si mund të ketë decentralizim?!

Duke u bazuar në atë se njëra ndër përparësitë e decentralizimit është bartja e kompetencave nga qendra në

Prej përparësive të decentralizimit është edhe ajo se, decentralizimi i lejon qytetarëve të merren dhe të vendosin mbi çështjet e lidhura me komunën dhe kështu të ndikojnë në realizimin e interesave të tyre, si dhe të kërkojnë përgjegjësi nga organet të cilat ata i kanë zgjedhur përmes zgjedhjeve lokale.

Procesi i decentralizimit mundëson efikasitetin e qeverisjes në nivel lokal dhe qendror, duke e shkarkuar pushtetin qendror nga përgjegjësitë dhe detyrat që mund të kryhen në nivel komunal dhe ndihmon në implementimin e efikas të vendimeve dhe ligjeve. Decentralizimi bën integrimin e minoriteve në shoqëri duke iu mundësuar atyre që në nivelin lokal të marrin pjesë në vendimmarrje dhe të ndikojnë në mënyrë të drejtpërdrejtë në realizimin e të drejtave të tyre në mënyrë institucionale. Decentralizimi nuk do të thotë autonomi për minoritete, por do të thotë autonomi për komuna. Decentralizimi do t'iu mundësojë komunave të kenë kompetenca më të mëdha në kuadrin e qeverisjes lokale.

Autonomia e komunave është me rëndësi të veçantë për procesin e demokratizimit. Autonomia ju mundëson komunave kompetenca më të mëdha, dhe qytetarëve mbikëqyrje më të madhe ndaj ekzekutivit. Autoritetet lokale nuk janë degë e ekzekutivit qendror, por janë institucione që dalin nga zgjedhjet lokale. Për këtë arsye këto autoritete duhen të gëzojnë të drejtat vetëqeverisëse në mënyrë që të realizojnë mandatin e tyre të besuar nga qytetarët në zgjedhjet lokale. Duke e shtjelluar këtë proces nga aspekti i njëanshëm, ose i kufizuar, është krijuar



Viena - selia e negociatave të dështuara

në përshtatjen ndaj kushteve dhe rrethanave të mjedisit të caktuar, në identifikimin më të lehtë të parregullsisë, në individualizimin e përgjegjësive, etj". Mangësitë të cilat ka ky proces janë: "mungesa e kujdesit për interesin më të gjerë, theksimi i tepruar i interesit të pjesshëm dhe mosfunksionimi i kontrollit".

organet më të ulëta, ne duhet të kemi parasysh se Kosova nuk i posedon të gjitha kompetencat në qendër. Andaj, përderisa nuk i kemi të gjitha kompetencat në qendër, si mund t'i shpërndajmë ato kompetenca?!

**Përparësitë e decentralizimit në Kosovë**

Botohet nga O.J.Q. "Zëri Ynë"

**Redaksia**

Drejtor: **Muhamed Jusufi - KAJOLLI**; Redaktor përgjegjës: **Shkelzen NUZA**; Redaktor gjuhësor: **Mimoza SINANI**; Redaktor Teknik/Grafika: **Osman D. GASHI**; Anëtarët e redaksisë: **Arber ZEKA, Ilir DESKU, Nexhati SPAHIU, Mergim LUSHTAKU, Gëzim QERIMI**; e-mail: [revistapaqja@gmail.com](mailto:revistapaqja@gmail.com), [revistapaqja@hotmail.com](mailto:revistapaqja@hotmail.com), [revistapaqja@yahoo.com](mailto:revistapaqja@yahoo.com); Adresa: Xhavit Mitrovica, nr. 14 përballë teatrit Dodona, Prishtinë, Kosovë;

Kontakti: +377 44 418 935, +377 44 637 111, +377 44 633 281

një përshtypje se ky proces ka për qëllim ndarjen territoriale të Kosovës. Kësaj i kanë kontribuar edhe propozimet e Serbisë për kantonizim, dhe më vonë për decentralizim. Kësaj pastaj i janë shtuar thëniet se dokumenti për reformën e qeverisjes lokale të Kosovës përmban edhe kërkesat serbe për kantonizim e kështu me radhë.

**Mangësitë e decentralizimit në rastin e Kosovës**

Sipas një hulumtimi të bërë nga Instituti Kosovar për Hulumtimin dhe Zhvillimin e Politikave (KIPRED) në lidhje me decentralizimin, del se shumica e të intervistuarve, për procesin e decentralizimit nëpër të cilin po kalon Kosova, shprehen se:

Decentralizimi nuk është prioritet i shoqërisë, studimi i ndarjes territoriale i komunave mund të bëhet vetëm mbasi të jetë përcaktuar statusi përfundimtar i Kosovës dhe decentralizimi i pushtetit nuk mund të ndodhë para centralizimit të tij. Sipas këtij studimi të bërë me qytetarët

ndërkombëtarë, edhe vendorë, thonë se Kosova nuk do të ndahet, dhe se serbët nuk do të fitojnë ndonjë autonomi brenda Kosovës. Në fakt Kosova është e ndarë dhe veriu i Kosovës, jo vetëm që ka autonomi, por ai është një shtet brenda autonomisë së Kosovës në kuadër të Serbisë. Kështu që shqetësimi ynë bazohet në realitetin faktik, e kjo është se Kosova realisht është e ndarë. Nuk është çështja se si të mos lejohet ndarja e Kosovës, çështja shtrohet se si të bashkohet ajo. Dhe politikanë dhe diplomatë të llojllojshëm duke thënë se Kosova nuk do të ndahet, ata duan vetëm ta relaksojnë popullin dhe të krijojnë iluzionin se njëmend Kosova nuk është e ndarë, ndërkohë që realiteti në terren është tjetër. Ky është realiteti, deshëm apo nuk deshëm.

Kur u përpilua për herë të parë projekti për decentralizimin e Kosovës nga Misioni i Këshillit të Evropës, nga shefi i këtij misioni Carlo Civileti u tha se decentralizimi i pushtetit në Kosovë, nuk

mirë këtë problem duke thënë se institucionet e Kosovës ende nuk kanë pushtet dhe aq më pak centralizim, dhe meqenëse nuk kanë centralizim, si do të mund të decentralizohen, pastaj a mund të depushtetëzohet Kosova para se të pushtetëzohet, sepse Kosova edhe ashtu nuk është e pushtetëzuar, meqenëse siç dihet, që të tre pushtetet janë në duart e përfaqësuesit special. Dilemë tjetër është se Kosova mund të reduktohet në kornizat e qeverisjes vendore dhe të mbetet një vakum më i gjatë, dhe se duhet të kemi parasysh se institucionet tona nuk kanë kompetenca të plota dhe se ato kompetenca që i kanë, nuk i shtrijnë autorizimet e tyre në tërë territorin e Kosovës.

Decentralizimi, përpara sovranitetit për Kosovën, e copëton Kosovën. Pushteti i decentralizuar nuk do t'i shkojë më afër qytetarit të Kosovës, por do t'i shkojë më afër Beogradit. Kudo nëpër enklava në Kosovë, të cilat bëjnë 25% të territorit të Kosovës, pushtetin e kanë strukturat e



Kuvendi i Serbisë - simbol i refuzimit të pavarësisë së Kosovës

kosovarë, del se shumica e të intervistuarve deklarohen për mangësitë të cilat bart procesi i decentralizimit në periudhën nëpër të cilën po kalon Kosova. E meqë qytetarët deklarohen kundër procesit të filluar, ne mund të konkludojmë se modelin e decentralizimit do të duhej ta sugjeronin qytetarët, sepse atyre ju referohet.

Një çështje tjetër është se me decentralizim mund të shkohet edhe deri te ndarja e Kosovës. Shumë politikanë, edhe

do të fillojë pa mënjanimin e të gjitha strukturave paralele. Mirëpo kjo nuk po ndodh sot e sa muaj mbas deklaratave të këtyre zyrtarëve ndërkombëtarë. Me decentralizim, strukturat paralele jo vetëm që nuk po shuhet, por ato vetëm sa po forcohen tash me bisedimet e Vjenës, duke kërkuar lidhje vertikale me Beogradin.

Sa i përket mangësive që i disponon decentralizimi në rastin e Kosovës, citoj prof. Esat Stavilecin, ku e sqaron shumë

Serbisë dhe pa u shpërbërë këto struktura, pushteti do t'u kalojë sërish atyre, përkatësisht Serbisë. Qëllimet e decentralizimit janë shumë të rrezikshme dhe të dëmshme, madje jo vetëm për të ardhmen tonë të afërt, dhe ato janë: zgjerimi i enklavave ekzistuese, legalizimi dhe zyrtarizimi i enklavave dhe strukturave aty, pastaj ndërlidhja territoriale e enklavave dhe përfundimisht krijimi i entitetit autonom serb brenda Kosovës.

Intervistë me Dr. Feti Mehdiu-n, profesor në Fakultetin Filologjik, Dega e Orientalistikës

## DALLIMI MES ORIENTALISTIKËS BOTËRORE DHE ASAJ SHQIPTARE ËSHTË SHUMË I QARTË

**Qëllimi i studimeve është të përgatisë kuadër i cili do të hulumtojë burimet osmane dhe të kontribuojë për studimin e historisë shqiptare në periudhën e sulltanatit osman, pasi që në këtë periudhë literatura dhe burimet arkivore janë të shkruara në gjuhën turke, por me shkronja arabe të përshtatura për periudhën osmane.**

**PAQJA: Çfarë mund të na thoni rreth historikut të themelimit të degës së orientalistikës, që nga fillimi e deri më tani?**

**F. Mehdiu:** Në kuadër të Universitetit të Prishtinës, në Fakultetin Filologjik ekziston Dega e Orientalistikës, e cila ka filluar punën në vitin shkollor 1973/74. Kur Kosova ishte pjesë e Federatës Jugosllave, kjo degë u themelua në sajë të plan-programeve të degëve të tjera si motra, që kishin filluar punën më herët në dy kryeqendrat e njohura të Jugosllavisë-Serbisë në Beograd, dhe të Bosnje dhe Hercegovinës në Sarajevë. Pak gjëra ndryshuan nga ai model i programit mësimor, i cili u modifikua për rrethanat e studentëve shqiptarë.

Fillimisht, mësimi zhvillohej në tri gjuhë: shqipe, serbokroate dhe turke. Gjatë kësaj periudhe, përkundër vështirësive materiale me të cilat ballafaqohej ky

qenë gjithmonë këtu. I ndjeri Kalessi nuk arriti ta përcillte as brezin e parë, sepse vdiq më 1976. Më pas dega u pasurua edhe në këtë aspekt. Brenda dhjetë vjet

dy herë takime të arabistëve, në bashkëpunim me katedrën në Beograd dhe Sarajevë. Takimi i parë u mbajt në Prishtinë kurse i dyti në Beograd.



### Fakulteti i Filologjisë

ekzistimi dega u pasurua me 18 mësimdhënës e bashkëpunëtorë, të cilët ishin inkuadruar në marrëdhënie të përhershme pune dhe kujdeseshin për mbarëvajtjen e mësimi. Këtu janë edhe frytet e kësaj dege, ish-studentët që i kryen studimet këtu dhe vazhduan perfeksionimin profesional. Prej tyre njëmbëdhjetë ishin profesorë universitarë, gjashtë bashkëpunëtorë dhe një bibliotekist.

Arsimtarët dhe studentët e kësaj dege marrin pjesë aktive në mbarë veprimtarinë e fakultetit, duke i kryer detyrat e tyre me ndërgjegje të lartë. Ata janë aktivë dhe kontribuojnë edhe jashtë procesit mësimor në fushën e shkencës dhe kulturës. Nga ky kuadër kemi një sërë veprash të përkthyer nga gjuha arabe dhe nga gjuha turke, në gjuhën shqipe dhe në gjuhën serbokroate.



institucion arsimor e shkencor, megjithatë u arritën rezultate të lakmueshme. Katedra filloi punën me mungesë të dukshme kuadri, pra në fillim ligjëronte vetëm Dr. Hasan Kalessi, të cilit më pas iu bashkëngjiti edhe Sebehate Mahmuti. Pastaj unë, nga marsi i vitit 1974 kam

**PAQJA: Sa ka qenë interesimi i studentëve në këtë drejtim?**

**F. Mehdiu:** Interesimi i studentëve për vijimin e studimeve orientalistike ka qenë i kënaqshëm deri në vitin 1990, ku varësisht sipas kriterëve që i zbatonte fakulteti në regjistrimin e studentëve pranoheshin 40-60 studentë në vit. Gjatë periudhës 1977-1987 studimet i kanë kryer 82 studentë, prej të cilëve 36 shqiptarë, 34 boshnjakë dhe 12 turq. Nga të diplomuarit, shtatë janë inkuadruar drejtpërsëdrejti në procesin mësimor në këtë degë, kurse të tjerët kontributin e tyre në këtë lëmi e japin në organizata të tjera punuese si në botën arabe, si përkthyes, si edhe në institucionet arsimore, kulturore, informative, etj. Deri më tani kanë diplomuar mbi 200 studentë, prej të cilëve 3 serbë, dy nga Kosova dhe një serbe nga Leskovci i Serbisë. Dega e orientalistikës në Prishtinë ka organizuar

**PAQJA: Çfarë mund të na thoni për personelin e kësaj dege, a janë të mjaftueshëm apo ka mungesa?**

**F. Mehdiu:** Tani për tani dega e orientalistikës ka pesë arsimtarë, tre të gjuhës arabe dhe dy të gjuhës turke, pa asnjë asistent. Biblioteka është e mbyllur për shkak se nuk ka bibliotekist. Është thënë nga organet kompetente se nuk ka të holla për t'u paguar. Kjo në masë të dukshme vështirëson qasjen e studentëve në literaturë. Përndryshe biblioteka është relativisht e furnizuar mirë me literaturë arabe, turke, shqipe dhe serbokroate. Me literaturë profesionale na ka ndihmuar në furnizim Siria dhe Turqia. Nga lëndët që studiohen në degën e orientalistikës janë: gjuha arabe dhe turke së bashku me letërsitë e tyre, po ashtu merren bazat e gjuhës persiane, e përveç kësaj këtu mësohet edhe gjuha shqipe, angleze - ose ndonjë tjetër, sipas dëshirës. Po ashtu mësohet: filozofia, psikologjia, infor-

matika, historia osmane, shkrimet shqipe me shkronja arabe, etj.

**PAQJA: Cili është qëllimi i studimit të kësaj dege në vendin tonë?**

**F. Mehdiu:** Qëllimi i studimeve është të përgatisë kuadër i cili do të hulumtojë burimet osmane dhe të kontribuojë për studimin e historisë shqiptare në periudhën e sulltanatit osman, pasi që në këtë periudhë literatura dhe burimet arkivore janë të shkruara në gjuhën turke, por me shkronja arabe të përshtatura për periudhën osmane. Dihet se administrata osmane, gjatë pesë shekujve sundimi në këto troje, ka përcjellë dhe ka evidentuar tërë ngjarjet që janë zhvilluar te shqiptarët dhe rreth tyre. Gjithë ajo lëndë që ka të bëjë me historinë e vendit tonë, posaçërisht ajo arkivore, ndodhet në

sociale, ekonomike dhe kulturore e këtij populli. Kronika të ndryshme, krijime letrare në poezi, prozë, madje edhe interpretime të veprave shkencore nga fusha të ndryshme të dijes nga autorë shqiptarë presin ditët ku do t'u qaset ndonjë dorë e përgatitur profesionalisht, e cila do t'i lexojë drejt dhe do t'i përkthejë e përpunojë këto materiale dhe ato t'ia ofrojë opinionit të interesuar shqiptar. Ato burime natyrisht janë të shkruara me alfabetin osman, të cilin përveç orientalistëve të specializuar për këtë fushë, kuadrot e tjerë nuk kanë mundësi t'i lexojnë. Pikërisht këtu del në shesh lidhshmëria e pandashme e historisë sonë kombëtare me orientalistikën shqiptare. Vetëm me një angazhim të gjithmbarshëm të tërë strukturave shoqërore kombëtare mund të arrihet

nuk është e mbështetur në baza të shëndosha, sidomos ajo e periudhës së sundimit osman, dhe nuk mund të jetë histori objektive derisa periudha 1385-1912, sa zgjati sundimi osman në trojet shqiptare, të mos hulumtohet dhe të studiohet burimisht dhe në hollësi. Mbetet detyrë e kuadrove të rinj, të cilët sigurisht kanë nevojë për përkrahje konkrete nga institucionet përkatëse kulturore e shkencore, që të thellojnë studimet në fushën e orientalistikës për të kryer obligimet ndaj historisë kombëtare, si nga aspekti i historisë politike, kulturore, ekonomike, ashtu edhe në fushën e letërsisë për të ndriçuar një varg figurash të shquara letrare, por edhe për nevoja aktuale të komunikimit të drejtpërdrejtë me një kulturë të vjetër, e cila i ka dhënë kontribut të çmuar edhe letërsisë, edhe qytetërimit evropian.



Az'hari, universiteti më i vjetër në botë.

arkivat e Turqisë. Në ato arkiva ka mbetur deri më sot i pashfrytëzuar një burim shumë i rëndësishëm. Përveç burimeve arkivore, për historinë tonë kanë rëndësi të veçantë për studimet në fushën e onomastikës, epigrafisë, por janë të rëndësishme edhe për topo-grafinë, statistikën, ekono-minë, tregtinë, artin, etj, që i përkasin asaj periudhe. Asnjëra nga këto disiplina nuk mund të studiohet nga dijetarët që nuk kanë përgatitje në fushën e studimeve orientale, e kjo në profilin e orientalistikës shqiptare nënkupton studim-in e gjuhës arabe, alfabeti i së cilës është bazë e shkrimit të gjuhës turke për periudhën osmane dhe studimin e gjuhës turke me të cilën janë shprehur dhe shkruar tërë ndodhitë gjatë pesë shekujve, si p.sh. regjistrimi i popullsisë, i pasurisë, profesioni, gjendja

orientimi dhe përgatitja e nevojshme e kuadrit përkatës, që mund të arrihet edhe me ndihmën e vendeve arabe dhe të Turqisë.

**PAQJA: Sa njerëz ka vendi ynë të cilët kanë njohuri për historinë, kulturën dhe trashëgiminë orientale?**


**F. Mehdiu:** Është e vërtetë e hidhur se brenda territorit shqiptar institucionet qendrore, shkencore e kulturore, si bibliotekat kombëtare, muzeumet historike, arkivat shtetërore dhe ato lokale, institucionet e historisë, qendrat e studimeve albanologjike, institutet për mbrojtjen e trashëgimisë kulturore etj. kanë ekspertë shumë të rrallë nga kjo lëmi. Të gjithë dijetarët shqiptarë, sidomos historianët, e theksojnë vazhdimisht se historia e popullit shqiptar

**PAQJA: Ku dallohet orientalistika shqiptare nga ajo perëndimore, kur dihet mirë se orientalistika si degë është themeluar për ta mësuar dhe sulmuar islamën?**

**F. Mehdiu:** Fillimisht duhet insistuar, të paktën te opinioni shqiptar, që të bëhet një dallim ndërmjet misionarëve anti islamë dhe atyre që studiojnë disiplina të orientalistikës, apo studimeve orientale. Dallimet janë evidente ndërmjet orientalistikës botërore dhe asaj shqiptare. Në fillim është mirë që të dallohen paragjykimet nga vlerësimet e mirëfillta. Paragjykimet në asnjë fushë nuk janë të mira. Sidomos kur përvihen e hyjnë edhe në shkencë, ato bëhen edhe më të rrezikshme. Kohëve të fundit flitet, dhe pothuajse ka filluar të ndërtohet një platformë, se të gjithë orientalistët, të gjithë ata që i studiojnë fushat e orientit janë anit islamë. Për këtë unë mendoj se para së gjithash duhet të bëhet një hulumtim, ose një analizë e kësaj fushe, duke filluar nga shekulli 12 e këndej dhe të shihet edhe kontributi i orientalistëve për fushat konkrete. Me sa kam unë njohuri, kjo nuk është bërë. Pa asnjëfarë analize, por vetëm ashtu kuturu është lëshuar njëfarë parulle se orientalistët janë anti islamë dhe mbi atë janë ndërtuar botëkuptime të ndryshme të shtresave të ndryshme në fushën e publicistikës, të intelektualëve në kuptim ma të gjerë, e mandej çka është edhe më keq, kjo ka depërtuar edhe në disa qarqe ku studiohet kultura e orientit orientalistika. Nuk bëjnë dallimin se kjo nuk merret ekskluzivisht vetëm me Islamën, por është diçka më e gjerë. Kultura e orientit, apo studimi i fushës së orientalistikës,

është më i gjerë se fusha islame. Nga këto mosdallime ka filluar të nxjerrë krye edhe në mesin tonë njëfarë platforme se ai që studion orientalistikën është anti islam. Mund të ketë pasur, ndoshta edhe tash ka, në botë të atillë, por në mesin shqiptar jo. Këtu duhen bërë disa dallime. Flitet se në fillim qarqet evropiane, kur kanë dashur ta mësojnë Kur'anin, kanë mësuar arabishten që ta përkthejnë Kura'nin, dhe kjo mund të jetë e vërtetë, dhe nuk duhet të ketë paragjykim se kjo është bërë vetëm për ta sulmuar Islamin. Bota ka dhënë orientalistë që e kanë vlerësuar Kur'anin dhe Islamin, në përgjithësi. Ata e kanë mësuar nga kureshtja për ta njohur fenë islame, sepse siç dihet feja islame që nga shekulli i tetë, sidomos prej shekullit të 12-të, ka qenë jo vetëm e pranishme, por ka ushtruar edhe ndikim në Evropë. Asokohe kanë punuar njerëz të ndryshëm, ka pasur edhe misionarë të cilët, ndoshta edhe nuk kanë qenë orientalistë, por vetëm misionarë anti islamë. E këtu duhet bërë dallimi nga ata që nuk janë orientalistë, po janë anti islamë. Ai mund të jetë anti islam edhe pa e studiuar gjuhën arabe, pa e studiuar fenë islame, por mund të ketë edhe nga ata të cilët e kanë studiuar fenë islame dhe kanë qenë anti islamë, por ata nuk duhet të përgjithësohen. Dallimi mes orientalistikës botërore dhe asaj shqiptare mendoj se është shumë i qartë. Në qoftë se në Evropë ka pasur frymë, ka pasur tendencë që ta studiojnë këtë fushë me qëllim që ta kundërshtojnë fenë islame, në orientalistikën shqiptare, me sa di unë, nuk ka të tillë. E kam fjalën për ata që e studiojnë këtë lëmi. Ne studime islame, në një farë mënyre, kemi pasur shumë më herët, por studimet orientale me të cilat kuptojmë të mësuarit e gjuhës arabe, të mësuarit e gjuhës turke dhe të mësuarit e gjuhës perse, nuk kemi pasur deri në vitin 1973. Përmenda këto tri disiplina sepse këto janë boshti islam për hapësirën shqiptare dhe jo vetëm shqiptare. Burimi islam është në gjuhën arabe, të parët pas arabëve e pranuan persianët, dhe me anën e turqve arriti në Ballkan te shqiptarët. Dashuria jonë vjen nga respekti për ta njohur botën arabe, turke e perse, si botë islame. Kur përmendim orientalistikën nuk duhet që menjëherë të na shkojë mendja për armiqitë e Islamit. Këtë epitet ia kanë dhënë pa të drejtë ndokush nga Lindja, i kanë dhënë ngjyrë shumë të keqe një fushë të dijes me shumë interes edhe për Perëndimin, edhe për Lindjen. Lidhja e popullit shqiptar me orientalistikën, besoj se është lidhje fisnike, jo me qëllime tendencioze. Kjo e lidh popullin

shqiptar përmes faktorit fetar me tërë botën islame dhe me kulturën e orientit, duke nisur nga Turqia e tutje. Për ne është shumë e nevojshme që përveç gjuhës arabe të mësohet edhe gjuha turke. Ka pasur mendime në mesin tonë se është e tepërt të mësohen këto dy gjuhë, ka pasur mendime se është më mirë të ndahet gjuha arabe dhe gjuha turke, por këtë katedra jonë nuk e ka pranuar. Unë jam i bindur se kuadri që nuk i njeh mirë të dyja këto fusha, aq sa i mundësojnë kushtet konkrete, nuk mund të shfrytëzojë arkivat turke, prandaj ne kemi insistuar se orientalistika shqiptare të ketë gjuhën arabe dhe gjuhën turke. Në të ardhmen do të jetë edhe gjuha perse, e cila për shkaqe objektive nuk është bërë e barabartë me dy të parat, aktualisht është vetëm si lëndë opcionale.



**PAQJA: A ka interesim nga ana juaj për zbardhjen e dokumenteve të vjetra shqiptare që janë në arkivat e shtetit turk?**

**F. Mehdiu:** Po, kur është hapur kjo degë tek ne është hapur me atë qëllim. Të zbulohen e të studiohen dokumentet e periudhës osmane që kanë të bëjnë me historinë e popullit shqiptar, mirëpo për

fat të keq ajo dëshirë dhe ai qëllim është realizuar shumë pak. Nuk mjafton të kesh vetëm vullnet dhe të kesh dëshirë. Vullneti është shumë i madh, por mundësitë e tjera e diktojnë realizimin. Këto dëshira dhe këtë interesim e kanë shprehur gjatë bisedave tona edhe Instituti Albanologjik, Instituti i Historisë, Arkivi i Kosovës, etj. Ata shprehin gatishmëri dhe përkrahje mjaft të madhe për ta përparuar këtë fushë, por në mungesë të potencialit financiar, nuk është realizuar asgjë. Këtu pra duhet të gjenden mjetet që ata, të cilët kanë vullnet, kanë përgatitje profesionale dhe dëshirë, të ndihmohen. Ka shumë që dëshirojnë të studiojnë në këtë drejtim, por mundësia financiare nuk i lejon. Për të bërë hulumtime në arkivat e Turqisë, në të cilat ka miliona dokumente edhe për fushën e historisë e të kulturës shqiptare, duhet një përkrahje e madhe financiare që të ndihmohen kuadrot e rinj të shkojnë atje. Kjo nuk është një punë e lehtë. Në fakultetin tonë ata studentë që marrin njohuri në degën e orientalistikës, mund të bëhen shumë shpejt kuadro për hulumtime në arkiva e biblioteka të Orientit, por ata duhet të ndihmohen. U duhet edhe një përgatitje shtesë të paktën për një 5 a 6 muaj, e deri në një vit, e pastaj prej tyre mund të priten punë në hulumtimet shkencore. Deri më tash është bërë pak punë në këtë drejtim. Më tepër me vetiniciativë e me përkrahje vullnetare nga dashamirët e shkencës. Në këtë lëmi institucionet e qeverisë turke ofrojnë mundësi solide për hulumtime. Për këtë qëllim mendoj se duhet të angazhohen institucionet përgjegjëse shkencore e kulturore nga e tërë hapësira shqiptare, dhe vetëm pas kësaj mund të priten rezultate.

**PAQJA: Dhe në fund, cili është mesazhi juaj për opinionin?**

**F. Mehdiu:** Në fund mund t'i rikujtoj opinionit, posaçërisht brezit të ri, tri porosi, të cilat për mendimin tim janë të pazëvendësueshme. T'i përmbahen urdhrat të Kur'anit, "mëso në emër të Zotit, Krijuesit tënd ... fjalës së Pejgamberit Muhammed a.s "kërko dituri prej djepit e gjer në varr, ... qoftë edhe në Kinë", por edhe konstatimit të Naim Frashërit se "vetëm dritë e dituri përpara do të na shpjerë".

Nëse këto kuptohen drejt dhe zbatohen drejt, kjo do të ishte shpresa për ardhmëri më të mirë, më të lumtur dhe më stabile.

Intervistoi **Nexhati Spahiu**

Zhvillimet në Maqedoni

## **ME MENDËSI BALLKANIKE DREJT STRUKTURAVE EUROATLANTIKE**

**Përderisa shqiptarët kanë probleme me veten, maqedonasit ende i preokupon përdorimi i gjuhës shqipe. Partitë politike maqedone problemet brendapërbrenda spektrit të tyre politik i zgjidhin më lehtë. Do të ishte fat i madh që kësisoj t'i zgjidhnin pakënaqësitë e tyre edhe partitë shqiptare.**

Maqedonia është një ndër vendet që ka nënshkruar marrëveshjen e asocim - stabilizimit me Bashkimin Europian. Me këtë akt ky vend ka hedhur hapin e parë drejt integrimeve europiane. Megjithatë, edhe pse praktikisht mund të duket afër ai moment kur Maqedonia do të hyjë në Europë, kjo duket larg për nga dimenzioni i pjekurisë politike e kulturore të politikanëve të saj, e në veçanti atyre shqiptarë. *Prirja anakronike për t'u marrë të gjithë me politikë, solli momentin më të padëshiruar: që me të gjithë të merret politika.*

Kjo të kujton një mendim të intelektualit të njohur shqiptar Branko Merxhan të shprehur para më se shtatëdhjet vitesh. Në numrin e parë të revistës "Përpjekje shqiptare", përfaqësuesi i neoshqiptarizmit dhe njëherit i botëkuptimit introspektiv të kulturës shkruante: "Kush merret këtu midis nesh me politikë, merret po thua me hiç gjë. Flë tërë ditën duke zënë miza".

Këtë vit dy partitë më të mëdha shqiptare në Maqedoni ajo në pozitë (PDSH) dhe ajo në opozitë (BDI) e filluan për së prapthi. Si njëra ashtu edhe tjetra u dërgoi mesazhe urimi për fillimvitin të gjitha partive, përfshirë edhe atyre maqedonase, por ato nuk shkëmbyen urime të ndërsjella që të paktën me një mesazh urimi t'i lanin sadopak ato mëkate që u pollën gjatë fushatës elektorale.

Këto parti vazhduan avazin e tyre dhe në vend se të investojnë tërë mundin dhe energjinë në avansimin e ligjeve që do ta përmirësonin gjendjen e shqiptarëve në përputhje me Marrëveshjen e Ohrit, ato merren me thashetheme të panevojshme. Shtabet e tyre janë agjenci thashethemesh.

Si duket e gjithë kjo bëhet me qëllim që të mbahet disi vëmendja e opinionit, të thuhet diçka sa për t'u thënë dhe me këtë të dëshmohet të qenurit aktiv për diçka. Në fund të muajit të shkuar kryetari i Bashkimit Demokratik për Integrim Ali

Ahmeti në një intervistë dhënë të përditshmes maqedonase "Dnevnik" theksoi se disa politikan të Maqedonisë, të Serbisë dhe të Kosovës kanë pasur plan ta ndajnë rajonin. Ai publikoi emrat e tre aktorëve të këtij plani: Arbën Xhaferi, Lupço Georgievski dhe Zoran Gjingjij, duke mos përmendur emrin e një përfaqësuesi nga Kosova.

Siç transmetohet Ahmeti ka deklaruar se faktorë për luftën kanë qenë Xhaferi dhe

deklarata e kujt do qoftë, por mentaliteti që i prodhon ato. Logjika që priret të ndërtojë avantazhe me akuzë e kundër-akuzë, pastaj edhe me kërcënime, është tamam rrjedhë e mentalitetit ballkanik. E kur thuhet ballkanik, atëherë gjithnjë mendohet për diçka që është ende rigjide, e papërpunuar, e papjekur...

Rrethi vicioz që përbën strumbullarin e një mentaliteti të tillë udhëhiqet nga prirja për të marrë mendimin mohues si prijtar

A po ngecë integrimi i Maqedonisë në BE



Georgievski me politikën e tyre të gabuar dhe se ai ishte në krye të UÇK-së për shkak se nuk dëshironte të lejojë që Maqedonia të shndërrohej në Liban ose Palestinë.

Pas kësaj deklarate reagoi zëvendëskryetari i PDSH-së Menduh Thaçi. Ai e paralajmëroi liderin e BDI-së se do të përballet me padi për shpifje ndaj kryetarit të partisë së PDSH-së. Thaçi po ashtu publikoi se emri i përfaqësuesit të cilin Ali Ahmeti e lë anonim, aludohet në Hashim Thaçin.

Çështja që është më thelbësore se prononcimet e tilla, është jo deklaratat si

për t'u futur në beteja të reja. Secili kritikon duke u nisur nga pozitë e interesave të ngushta vetjake ose partiake.

Refreni që përsëritet në këtë kontekst është pothuajse i njëjtë: "Kur ishim ne në pushtet, e kemi zgjidhur më mirë këtë ose atë çështje / kur të vijmë ne në pushtet do t'i heqim këto ose ato padrejtësi".

Në Maqedoni vetëm sa shtohet zelli i shqiptarëve për të kritikuar ashpër gjithçka dhe sidomos njëri-tjetrin. Niveli i llumit të vullgariteteve ngrihet mbi vlerat intelektuale.

Njëherë lideri ose drejtuesi kryesor

politik i partisë ku aderohet adhurohet verbtazi me servilizëm të neveritshëm, krijohet kulti i tij me propagandimin vetëm të anëve pozitive, duke u paraqitur ai pothuajse si ëngju ose gjeni, pa asnjë



të metë e mangësi. Pas prishjeve të marrëdhënieve të tilla, kryesisht për interesa të ngushta vetjake, braktisen pozitën e adhuruesit dhe kalohet në taborret e akuzave patologjike. Adhurimet shndërrohen në fyerje nga më të shëmtuarat, kurse kulti kthehet në person “non-grata”.

Duke ndërtuar sfondin politik në këto premisa krijohet një atmosferë e pakëndshme dhe e padurueshme për intelektualët e mirëfilltë, por që posedojnë edhe dinjitet. Kjo është e rëndësishme të theksohet, sepse një pjesë e intelektualëve pas tjetërsimit politik, zor e kanë ta njohin edhe veten e tyre. Nuk mund ta gjejnë vetveten as në të kaluarën e as në të tashmen.

Përderisa shqiptarët kanë probleme me veten, maqedonasit ende i preokupon përdorimi i gjuhës shqipe. Polemika e fundit në këtë kontekst kishte të bënte me atë që gjuha shqipe të mos përdoret në të gjitha instancat e parlamentit, por vetëm në fjalimet e deputetëve dhe nëpër komisione. VMRO-DPMNE insiston në atë se të drejtën e përdorimit të gjuhës shqipe e kanë vetëm kryetarët e komisioneve parlamentare që janë shqiptarë. LSDM pohon se nëni 3 i rregullores së punës së kuvendit që është miratuar në qershor të 2002, precizon se deputeti mund të flasë në seancë në gjuhën amtare, por nuk ka nen i cili përcakton se mund të udhëheq me komisionet parlamentare në gjuhën amtare.

Partitë politike maqedone problemet

brendapërbrenda spektrit të tyre politik i zgjidhin më lehtë. Pas humbjes në zgjedhjet e fundit parlamentare ndryshimi në kreun e socialdemokratëve u bë në mënyrë tejet demokratike.

Do të ishte fat i madh që kësaj t'i zgjidhnin pakënaqësitë e tyre edhe partitë shqiptare.

Në teatrin shqiptar të Shkupit në fillim të këtij muaji u shfaq premiera “Kolonel Zogu”. Atë e përcolli edhe kryeministri maqedonas Nikolla Gruevski. Temë e kësaj shfaqjeje teatrale ishte jeta e disa njerëzve të cilët jetonin të izoluar, larg botës së civilizuar, si pacientë në një klinikë psikiatrie. Mënyra e jetës së tyre pasqyronte një gërshetim mes rendit dhe kaosit, të kaluarës dhe të tashmes, drejtësisë dhe padrejtësisë, normales dhe jonormales. Realiteti ishte vënë artistikisht në skenë.

Në vazhden e këtij filmi edhe loja e partive politike shqiptare në Maqedoni, e në veçanti e dy partive më të mëdha, të kujton pacientët e Minkovskit, gjegjësisht përgjigjet e tyre në një pyetje të rëndomtë që u bëhet: “Ku jeni?”

Njëri nga ta, i paralizuar, në vend se të përgjigjet në këtë pyetje, tregon shtratin në të cilin ishte i shtrirë, kurse tjetri përgjigjet: “e di se ku jam, por nuk e ndjej veten se jam aty”.

Pa marrë parasysh etjen dhe oreksin e madh që të hyhet në Europë me çdo kusht, duket se për shkak të mentalitetit do ta meritonim edhe më tej këtë kaos ballkan-


ik. Në vendet ku politika e politikani vlerësohet më shumë se shkenca dhe intelektualit, s'ka shpresë për ndonjë prosperitet të vërtetë.

Dr. Zyhdi Dervishi duke treguar përvojën e tij gjatë qëndrimit në Universitetin “Fridrich Shiler” të Jenës, rrëfen se si gjatë fushatës elektorale 98 një profesor t'i ketë thënë se fituesi i zgjedhjeve do të dilte Gerhar Shrederi. Si arsye kryesore ai kishte cekur faktin se në anën e socialdemokratëve kishte dalur edhe sociologu më i shquar i Gjermanisë Jurgen Habermas. Dhe ashtu edhe doli. Duke u nisur nga mentaliteti shqiptar sociologu Dervishi e kishte pyetur se çka do ta bëni Habermasin, ngase te ne për një kontribut të tillë, ai do të bëhej president. Profesori gjerman i ishte përgjigjur se në Gjermani nuk ka burrë aq të guximshëm që t'ia bënte këtë propozim Habermasit, pasi që do të ishte nënvlerësim për të.

Pavarësisht kush zgjidhet president, Habermasi është profesor i të gjithë presidentëve, është pasuri kombëtare e Gjermanisë. Për çdo çështje të rëndësishme, shteti gjerman i referohet mendimit të Habermasit. Pra në Gjermani dhe në përgjithësi në vendet perëndimore, mendimi i intelektualit vlerësohet më shumë se shkathësia e nëpunësit.

Te ne ndodh e kundërta. Prandaj është vështirë të mendohet se si do të jenë integrimet euroatlantike me mendësi ballkanike.

A.A



Arsimi i Lartë në Kosovë

## PRIORITET I SHOQËRISË DUHET TË JETË ARSIMIMI CILËSOR

**Kosova duhet të jetë shoqëri e hapur dhe e integruar në hapësirën evropiane të arsimit të lartë, ku dija dhe kërkimet shkencore janë në funksion të zhvillimit të qëndrueshëm kulturor, shoqëror dhe ekonomik.**

Gëzim QERIMI



Përkundër një tradite 37 vjeçare të arsimit të lartë në Kosovë, dhjetëvjetëshi i fundit i shekullit XX-të ka lënë gjurmë të thella në zhvillimin e sistemit të arsimit të lartë.


Izolimet dhe zhvillimet politike të kësaj periudhe kanë rezultuar me një ngecje në zhvillimin e arsimit, e cila fatkeqësisht vazhdon të jetë e evidente edhe në periudhën e pasluftës. Për të gjithë ne është e njohur koha e izolimit në Kosovë, e në veçanti koha e izolimit të arsimit të lartë, kur ai u detyrua të merrte rolin e rezistencës kombëtare më shumë se sa rolin të cilin duhen ta kenë institucionet e arsimit. Mirëpo e gjithë kjo është bërë në rrethana të tjera politike, ku profesorët dhe studentët ishin promotorë të të gjitha zhvillimeve politike në vend gjatë historisë, duke filluar nga organizimet e shumta gjatë viteve: 1968, 1989, 1997 etj. Dhe roli i tyre vlerësohet si shumë i rëndësishëm. Por, sot shoqëria kosovare ka nevojë për arsimim cilësor dhe në funksion të zhvillimit të saj.

### Problemet e sistemit të arsimit të lartë në Kosovë

Misioni i ri i arsimit të lartë është transformimi i arsimit të lartë, i cili faktikisht ka filluar. Mirëpo ky transformim po ndodh në rrethanat kur vendi po kalon periudhën e tranzicionit dhe të përcaktimit të statusit të vet politik. Pasi është dëshmuar që arsimimi i shoqërisë është promotor i gjitha zhvillimeve pozitive, duhet që edhe në këso rrethanash arsimimit t'i jepet përparësi në politikën zhvillimore. Andaj e gjithë shoqëria duhet ta kuptojë se misioni i arsimit të lartë në Kosovë është zhvillimi dhe përparimi i

vendit në të gjitha fushat e jetës.

Për shkak të rrethanave në të cilat arsimi i lartë punoi në vitet e '90-ta, të luftës në Kosovë, të statusit të pazgjidhur të Kosovës, të trajtimit jo adekuat të arsimit të lartë nga institucionet tona (Kuvendi, Qeveria dhe Ministria e Arsimit), të mungesës së fondeve publike dhe të fondeve e burimeve të tjera të dedikuara për fushën e arsimit, ekzistojnë një tërësi problemesh që do të renditen më poshtë në mënyrë të përmbledhur nga hulumtimet e shumta që janë bërë nga institutet e shumta që kanë pasur në fokus



edhe arsimin e lartë. Problemet e cekura më poshtë janë marrë nga materiali i strategjisë së zhvillimit të arsimit të lartë në Kosovë

(2005-2015), (Versioni final), Prishtinë Kosovë.

Në fushën e politikës dhe të legjislacionit:

1. Politika të pamjaftueshme për arsimin e lartë.
2. Legjislacion jo i plotë për arsimin e lartë.
3. Përfshirja e ultë e popullatës në arsimin e lartë.
4. Përfshirja e ultë e femrës në arsimin e lartë.
5. Mungojnë politikën stimuluese pozitive për mësimdhënës dhe studentë për punë kërkimore-shkencore.
6. Politika financiare është e bazuar në qasje të kufizuar.
7. Vërehet dukuria e largimit të kuadrove të reja nga Kosova, etj.

Në fushën e menaxhimit dhe të koordi-

nimit si dhe në atë të kërkimit shkencor:

1. Mungon një sistem i mirëfilltë për menaxhim të arsimit të lartë, që bën të pamundur definimin e qartë të kompetencave, përgjegjësisë, si dhe të kontrollit të suksesit, apo mosesuksesit në punë.
2. Mungojnë mekanizmat e kontrollit dhe të llogaridhënies në çdo nivel.
3. Mungojnë politikën dhe programet për kërkime shkencore.
4. Mungon bashkëpunimi ndërkombëtar në hulumtime.
5. Mungon infrastruktura institucionale për punë shkencore, etj.

Më lart janë shkëputur vetëm disa prej pikave apo problemeve që janë hasur nga grupet e shumta punuese në hartimin e strategjisë së arsimit të lartë, dhe që kërkojnë zgjidhje.

### Arsimi i lartë cilësor ndihmon zhvillimin

Sistemit të arsimit të lartë i nevojitet zhvillimi në mënyrë të tillë që t'i shërbejë rendit të ri social, t'i përgjigjet kërkesave kombëtare dhe t'i përgjigjet realiteteve dhe mundësive të reja, të cilat i kërkon sot shoqëria moderne dhe tregu botëror.

Arsimi i lartë është një nga veprimtaritë më të rëndësishme në shoqëritë moderne. Ai krijon një mjedis ku individët mund të realizojnë potencialet e tyre intelektuale dhe hulumtuese zbuluese. Nëpërmjet trajnimeve të nivelit të lartë në disiplinë të ndryshme, ai i pajis njerëzit me njohuritë e domosdoshme, aftësitë dhe vlerat për të luajtur një rol të rëndësishëm në formimin e një shoqërie të zhvilluar në të gjitha fushat e jetës.

Arsimi i lartë cilësor i duhet Kosovës sepse mundëson zgjidhjen e sfidave kryesore të shoqërisë. Edhe Kosova po ashtu, sfidë kryesore duhet ta ketë arsimin e lartë, sepse ai i shërben zhvillimit të qëndrueshëm kulturor, social dhe ekonomik të vendit dhe mundëson integrimin e shpejtë të Kosovës në hapësirën evropiane dhe më gjerë.

## KUR DO TË PUSHOJË FJALA “KOPJE” PËR STUDENTËT E UP-SË?

“Shoqëri, po deshe që të mos lozin në kurrizin tënd, ndërro format, hiqi bragazhat!”

Migjeni

Plagjiatura është bërë modë kudo. Si virus ka filluar të infektojë shumë studentë, dhe është shndërruar në sëmundje. Dhe kjo sëmundje çdo herë e më tepër po merr përmasa akoma më të mëdha.

Se kur do të pushojë fjala “kopje” për studentët e UP-së, se kur do të arrihet grada e lartë e vetëdijes, dhe se kur viktima do ta kuptojë se në çfarë halli e ka sjellë vetvetja, këtë më së miri e di shoqëria në të cilën manipulon dhe manipulohet.

Kush e ka fajin?.....Studentët që gënjejnë veten, apo faji qëndron tek kriteret e disa profesorëve?

Si çdo herë, faji është i jetim dhe viktimë e fajit kush do të jetë tjetër, pos studentëve.

Ndërsa në vendet më të civilizuara, gjatë kohës së provimit profesori ua cakton pyetjet dhe del jashtë sallës së provimit, çfarë do të ndodhte në Universitetin tonë sikur të bëhej një gjë e tillë?

Këtë e dinë më së miri studentët. Nuk përjashtohen rastet kur bëhen mashtrime ballë për ballë me profesorin; ndërkohë që profesori merret me caktimin e pyetjeve, ai i cili pret të pyetet ia tregon shokut mbrapa, ky i fundit e përgatit përgjigjen, ndërrohen fletat dhe provimi kaloi. Po me këtë kopje, tjetri kërkon punë, punësohet dhe i mëson të tjerët. Po, po, i mëson ndoshta për rrugën se si kopjohet, d.m.th. mashtron por edhe mashtrohet, gënjën por edhe gënjejhet.

Janë të paktë ata studentë që mësojnë vetëm për dije, janë të paktë ata studentë që janë të sinqertë.

Por, për çudi, ka raste kur mashtrimet shihen qartas, por intervenimi është i dobët, ose “ndihmohen” nga vetë profesorët duke ua dhënë provimet në mënyra të ndryshme, dhe kështu diplomat false dhe origjinale nuk po hetohen nga organet kompetente, apo ndoshta edhe hetohen, po fatkeqësisht mashtrimet po bëhen edhe haptas.

O si nuk kam një grusht të fortë  
T'i bije mu në zemër këtij sistemi  
t'ia ndërroj format  
t'ia ndërroj bragazhat,

Po, po, t'i bije mu në zemër këtij sistemi, që po mashtron dhe po mashtrohet, që manipulon dhe po manipulohet. Por, për çudi, çdoherë revoltohen njerëzit 'e vegjël' që të vetmen formë, të vetmen armë që posedojnë për stagnimin e ndonjë problemi (e këtij krimi) kanë penën, e cila pak dëgjohej.

Dhe në fund u përkujtoj thënien e profetit Muhammed a.s., i cili thotë “Kush mashtron nuk është prej nesh.”

Sadbere Hashani

## Tensioni në Universitetin e Prishtinës II

# NË UP DUHET TË KETË SANKSIONE

**Problemet nuk zhduken vetvetiu, studentët dhe profesorët janë baza e Universitetit, por ata po veprojnë sikur të mos ishin fare në Universitet.**

Mergim LUSHTAKU

Brenda këtij viti (2007) gjendja në UP duhet të stabilizohet. Thuhet se gjendja në këtë kohë është stabilizuar, por në të vërtetë stabiliteti më i plotë dhe më i sigurt do të jetë atëherë kur të përfundojë misioni, apo detyrat përfundimtare të reformimit të UP-së. Nuk mund të thuhet se nuk ka shkelje në UP, sepse atëherë gënjejnë vetveten. Kemi shkelje dyanësore, si nga ana e studentëve, po ashtu edhe nga ana e profesorëve. Këtyre mund t'u thuhet se: “Zjarri nuk shuhet me zjarr”. Shumica e profesorëve pretendojnë se i aplikojnë reformat dhe se shkojnë sipas ECTS-së. ECTS-ja është në ndihmë të studentëve.

Rezultati do të jetë negativ për UP, po qe se vazhdohet në këtë mënyrë. Duhet të ketë sanksione në UP, pa marrë parasysh, se a e ke studentin koleg, apo e ke të afërm. Ligji është Ligj dhe është i barabartë për të gjithë.

Është për të ardhur keq se sa janë të vetëdijshëm studentët dhe profesorët për Deklaratën e Bolonjës. Me siguri se shumica e të lartpërmendurve nuk e di se cilat janë 10 pikat e Deklaratës së Bolonjës. Ato janë:

### 10 objektivat (parimet) e Deklaratës së Bolonjës:

1. Miratimi i një sistemi që krahason dhe qartëson (lexon) lehtë gradet shkencore
2. Miratimi i një sistemi që bazohet esencialisht në dy cikle studimi
3. Vendosja e një sistemi kredish
4. Promovimi i mobilitetit
5. Promovimi i bashkëpunimit evropian në sigurimin e cilësisë
6. Promovimi i dimensionit evropian në Arsimin e Lartë
7. Studim gjatë tërë jetës
8. Institucionet e Arsimit të Lartë dhe studentët
9. Promovimi i atraktivitetit në Hapësirën Evropiane të Arsimit të Lartë
10. Studimet e doktoratës, bashkëveprimi i Hapësirës Evropiane të Arsimit të Lartë dhe Hapësirës Evropiane të kërkimit shkencor

Për të kaluar nga një gjendje tensioni, duhet të kemi pasur parasysh se ku gjendemi, se a kemi një statut për t'u përmbajtur, apo do të vazhdojmë të punojmë pa kokë, duke injoruar statutin e UP-së, dhe atëherë dihet se ku do të na çojë kjo.

Ne e dimë se ku qëndrojmë, edhe statutin e kemi, mundësitë nuk i kemi të mjaftueshme, por jo dhe aq sa për të mos dalë nga një krizë dhe një tension.

Në mënyrë që Universiteti të shkojë përpara, dhe bashkë me të edhe Kosova, duhet që edhe të sakrifkohet. Ende duhen qartësuar shumë probleme në Universitet, si: numri i madh i studentëve në ligjërata, mungesa e infrastrukturës, mungesa e laboratorëve, e shumë probleme të tjera.

**Problemet nuk zhduken vetvetiu, studentët dhe profesorët janë baza e Universitetit, por ata po veprojnë sikur të mos ishin fare në Universitet.** Çfarë kemi pas kësaj? Kemi një Universitet të dështuar, në të cilin do të punohet vetëm për interesa personale. Edhe nëse fitohet Pavarësia, shpresa e këtij vendi nuk është në “Elitën” e tashme Politike, por është në gjeneratën e re. Vallë ku është gjenerata e re? Ku janë studentët?

Postmodernia te shqiptarët

## “EUFORIA FATKEQE” E SHQIPTARËVE NË POLITIKË

Njerëzit e aftë dhe të ditur janë demonizuar dhe marginalizuar. Kundruall tyre qëndron nëntoka e kontrolluar, kriminaliteti dhe sundimi i injorancës. Në fillim të gushtit të vitit të kaluar 'Koalicioni antikorrupsion' dhe Organizata për Demokraci dhe Dinjitet 'Çohu' i drejtoi letër të hapur qytetarëve, të cilëve ua bëri me dije se 82% e kabinetit qeveritar janë jokompetentë, të paprofesionalizuar për fushat që udhëheqin dhe pa shkollim të lartë.

Avni AVDIU

Kosova kaloi kapërcellin e situatave më turbulente. Njerëzit dhe ngjarjet të habitshme. Pa fuqi refleksive, masa i gëzohej, siç shprehej Herbert Markuze, me një 'eufori fatkeqe' organizimit të kaosit të ri. Kjo eufori ishte fatkeqe, pikërisht sepse në të u gjet ekstaza më e madhe. Me dëshira infantile siç rrinë kalamajtë në prag të Vitit të Ri, imagjinohej se 'Eldorado' do të vijë nga Perëndimi. Si dush i ftohtë nga kjo pritjeje doli papunësia dhe mjerimi social, ndonëse edhe ai gjëlltitej disi në terrin e vazhdueshëm që e rezervonte KEK-u. Frederik Jamenson theksonte se 'kur në një qytet prej 100 mijë banorësh ekziston vetëm një i papunë, atëherë ky është problemi i tij personal. Mirëpo kur në një vend prej 50 milionë janë 15 milionë të papunë, ky bëhet problem strukturor i shoqërisë. Kjo çështje pothuajse nuk i shqetëson fare ata që pretendojnë se bartin “probleme më të rënda jetike e vendimtare”. Mbi më tepër se 16 vjet popullin e udhëheq një kastë njerëzish me fuqi autoritare. Disa personalitete ishin produkt i situatës së krijuar, e disa të tjerë dolën si kërpudhat pas shiut. Injoranca ka lëshuar rrënjë dhe zotëron çdo pore të jetës: në politikë, në institucione, shëndetësi, madje edhe në arsim. Ajo ka krijuar rre-gulla dhe ka ndërnuar rrjet mbrojtës. Ky rrjet është bërë fortifikatë e hekurt që i reziston fuqisë kreative të dijës dhe ideve. Dija në kuptimin që ajo njihej më parë është avulluar, kurse përmes formës së re që tenton të depërtojë është tjetërsuar, pasi është monopolizuar nga struktura inkompetente. Njerëzit e aftë dhe të ditur janë demonizuar dhe marginalizuar. Kundruall tyre qëndron

nëntoka e kontrolluar, kriminaliteti dhe sundimi i injorancës. Në fillim të gushtit të vitit të kaluar 'Ko-



al-ic i o n i anti-korrupsion' dhe Organizata për Demokraci dhe Dinjitet 'Çohu' i drejtoi letër të hapur qytetarëve, të cilëve ua bëri me dije se 82% e kabinetit qeveritar janë jokompetentë, të paprofesionalizuar për fushat që udhëheqin dhe pa shkollim të lartë. Lëvizja “Vetëvendosja” akuzon edhe ekipin negociator të formuar nga përfaqësuesit e partive politike për tradhti, duke shpërndarë edhe afishe, ku populli ftohet për t'i kapur ata gjallë ose vdekur. Fuko është shprehur se 'në vendimet e liderëve, të cilët shkojnë drejt zgjidhjeve paqësore dhe të sigurisë, ka një pjesë tradhtie. Kjo lëvizje të kujton

lëvizjet ekologjike në botë që kot protestojnë për ndotjen e ambientit. Prapëseprapë ndotjet vazhdojnë, ngrohja globale s'ka të ndalur dhe kërcënimi i natyrës, ozonit dhe atmosferës mbetet permanent. Të kujtojmë vetëm ndryshimet drastike të temperaturave në fillim të gushtit (2006), që nga ekspertët e meteorologjisë dhe ekologët u shpjeguan me ndotjen e ajrit. Kjo bëri që kosovarët vetëm brenda një dite t'i përjetojnë tri stinë: verën, pranverën dhe vjeshtën. Ashtu po ndodh edhe në politikë. Kot ka shkrime, kot ka greva, protesta dhe demonstrime. Ndotja e politikës vazhdon...Kur të vijnë zgjedhjet, fillon loja e akuzave dhe kundër-akuzave: 'ju e bëtë atë e këtë...., ju ishit këta e ata', ndërsa kur të përfundojnë vazhdojnë sërish akuzat, por tash për vjedhje votash. Akuzat s'kanë të ndalur edhe pas konsolidimit të pushtetit. Fillon: mito, korrupsioni, nepotizmi...me një fjalë sundimi kleptokratik. “E vërteta shkruante Fuko - është sistem regjimesh. Me nocionin 'e vërteta' nuk mendojmë grumbuj të vërtetash, që duhet t'i zbulojmë dhe pranojmë, por grumbuj rregullash përmes të cilave dallohet e vërteta nga gënjeshtra dhe të vërtetës i jepen kahe të formës së pushtetit”. Për Deridën kjo do të thoshte 'falogocentrizëm', d.m.th dominim i racionalizmit mashkullor mbi vetëdijen njerëzore. Ndërkaq, sipas Fukos, e vërteta në thelb është armë partiake, se ajo paraqet elementin e pushtetit dhe se, për këtë shkak, rrënim i së vërtetës së push-tetit është gjithashtu i domosdoshëm.

Diskursi politik kalon në blofe. S'ka më gjuhë universale që do t'i pajtonte debatet e ndryshme që kryesisht janë ndryshime gjuhësore. Racio është zhdukur në formë unanimitisht të pranueshme. Secili e kupton, ose shtiret se e kupton, ndryshe të drejtën kushtetuese, instalimin e ligjit, respektimin e rregulloreve dhe të gjitha i shtron në kontekst tjetër konotativ. Çka është për njërin pozitive për tjetrin mund të jetë negative, ose çfarë njëri e konsideron të zezë, tjetri mund ta shohë si të bardhë. Është hequr prej kohësh demarkacioni i kuptimit strikt të fjalëve. Tashmë është e lejueshme që aty për aty të ndryshohen kuptimet. Leotari në frymën e Vitgenshtajnit fliste për teorinë e 'lojës gjuhësore'. 'Lojërat gjuhësore' janë pragmatike, të lokalizuara dhe dije thelbësisht sipërfaqësore. Sipas tij epoka postmoderniste shënon fundin e të gjitha miteve ngu-shëlluese rreth mbisundimit intelektual-ual dhe të së vërtetës, e cila ka ndryshuar nga 'loja gjuhësore'. Ben Agger para-lajmëroi kohën në të cilën intelektualët do të mbesin të privuar nga fjalët e tyre. Gjuha, gjithnjë e më tepër, po zhvlerësohet dhe po e humb rëndësinë që kishte, sidomos gjatë përdorimit publik.

Postmodernizmi e ka vënë gjuhën në mes të presës me dy tehe: konteston fuqinë e saj për ta formësuar botën, dhe fuqinë e vetëdijes për ta formësuar vetveten. Sosyr ishte i mendimit se gjuha nuk është funksion i subjektit folës, kurse Roland Barthes mendonte se gjuha flet, e jo folësi. Barthes shfaqti shpresën se me gjuhë mund të shërbehemi përmes mënyrës utopike dhe se në kulturë ekzistojnë rregulla të mbikëqyrjes që megjithatë mund të thyhen.



Ismail Kadare

'Dekonstruimi' nënkupton faktin se gjuha nuk është neutrale, por se bazohet në disa paragjykime, gjë që flet për diskursin kundërtënes të njeriut. Gjuha kthehet kundër vetvetes, ashtu që nuk mund të themi çfarë mendojmë dhe as të mendojmë çfarë themi. Metoda e dekonstruimit demistifikon përmbajtjet ideologjike të të gjitha teksteve, dhe me atë rast të gjitha veprimet njerëzore interpretohen ashtu sikurse të jenë në thelb tekste. Në gjuhë shihet fuqia e pavarur, e cila ndodhet në lëvizje në mënyrë të pandërprerë dhe pamundëson stabilizimin e domethënies ose komunikimin përmbajtësor. Brendapër-brenda këtij rrymimi krijohet edhe koncepti 'differance' dhe pikërisht ky nocion shkakton shka-tërrimin e vetë idesë së kuptimshmërisë, dhe me atë rast nuk konfiguron më hapësirë jashtë gjuhës, ku do të mund të ekzistonte kuptimi në çfarëdo qoftë mënyre. Leotar me nocionin 'differand' hetoi pamundësinë e reduktimit të të folurit brenda një konteksti universal, që do të shërbente për t'i përkthyer fjalitë e regjimeve të



Pamje nga protesta e "Vetëvendosjes"

ndryshme në njëri-tjetrin. Nga vetë gjuha rrjedh edhe konflikti mes dy palëve, ngase gjuha, e cila i përket njëres palë, nuk mund të dekodohet nga pala tjetër, e cila nuk ia arrin assesi të futet në regjimin tjetër gjuhësor. Në këtë mënyrë argumentet e asnjërës palë nuk kanë domethënie për palën që i përket regjimit tjetër gjuhësor.

Qëllimi dhe subjekti janë mposhtur, 'nuk shihet asgjë e vërtetë e brendshme, por vetëm se kuptime pakufishmërisht të mundshme që krijon 'differance', çka në parim karakterizon gjuhën. 'Differance' kalon gradualisht në indifferance-mospërfillje, për shkak se nuk ka më kongruencë ndërmjet të vërtetës dhe kuptimit, gjë që kontribuon të kalohet në cinizëm.

Nëse sadopak analizohen fjalët që përdoren në debatet ndërpartiake dhe në kundërshtimet e shumta që i karakterizojnë ato, shihet qartë se si projektohet tjetri; tamam ashtu siç thoshte Sartri 'ferr'. Gjuha e urrejtjes nuk



Rexhep Qosja

një asnjë kufi.

Kjo gjuhë është aktualizuar edhe në analiza politike, art dhe polemika akademike. T'i kujtojmë vetëm pak debatet pozitive-opozitive si në Shqipëri, Kosovë, Maqedoni, këngët shqipe të hip-hopit me shprehje vulgare, për të arritur gjer te polemika ndërmjet dy shkrimtarëve Kadare-Qosja. Pra gjuha e dekonstruimit, e demistifikimit, e diseminacionit, me një fjalë gjuha e potsmodernes është në parlament, në pushtet, në teatër, në këngë, në letra të intelektualëve, ku gjithnjë e më tepër krijon situata aporike gjuhësore, të cilat në shumë raste janë të pakapshme për masën.

Nga ana tjetër gjuha e racios ka zbritur në tokë, në zgafelle, në mitingje, në greva urie, në kërkimin e të zhdukurve nga lufta dhe në kërkesa të panumërta për jetë më dinjitoze. Grafitet dhe transparentet nuk i japin kësaj gjuhe fuqi të mjaftueshme për ta sfiduar 'gjuhën e hiper-realitetit'. Përkundrazi e bën atë qesharake dhe e hedh në zhanrin e humorit. Në një transparent që mbahej në duart e një protestuesi para PTK mund të lexohej për valën 900: "Vala nanëq..", por edhe pse kjo pasqyrore revoltën e arsyeshme, prapëseprapë më tepër ishte gjest për të qeshur, sesa për të shkaktuar ndonjë refleksion. Ky operator i telefonisë mobile vazhdonte të mbetej më i shtrenjti në Evropë me 88 euro për kartelë në vendin pothuajse më të varfër. As grafitet në mure, ndërtesa e institucione ku kërkohet vetëvendosje, rrymë, bukë, ujë etj, nuk duken diçka interesante, sepse më e zëshme është gjuha që e tejkalon këtë realitet ... gjuha që dëshiron ta paraqes këtë realitet si 'super', ose 'pseud', ose më mirë me thënë si diçka 'hiper'.

Prostitucioni në Kosovë

## “VËLLAZËRIA” E TRAFIKANTËVE SHKATËRRON MIJËRA JETË

**Policia vendore, nga 1 janari deri në fund të dhjetorit 2006, ka kontrolluar gjithsej 1285 lokale, prej të cilave 21 janë mbyllur për arsye tanimë të njohura. Aktualisht ekziston një numër i madh lokalesh të dyshimta për prostitucion, që tanimë policia vendore i ka futur në listë.**

Arber ZEKA

Mosfunksionimi i mirë i shoqërisë sonë dhe i institucioneve tona ka rezultuar edhe me rritjen enorme të trafikimit të genieve njerëzore dhe shfrytëzimit të tyre nga kriminelët për përfitime personale. Gjatë vitit 2006, përfshirë këtu periudhën janar-nëntor, në Kosovë janë trafikuar 63 viktima, nga të cilat: 30 femra moldave, 18 kosovare, 6 shtetase shqiptare, 3 ukrainase, 2 ruse, 2 bullgare dhe 2 të tjera.

Siç shihet nga këto statistika, moldavet prijnë edhe më tej listat e skllavërisë seksuale me 48%, dhe është krejt i habitshëm fakti se kosovaret janë të dytat me 30%.

Ekziston një rrjet i degëzuar i trafikimit, ku shpeshherë përfshihen edhe punëdhënës, fqinj, miq, pjesëtarë të familjes e të tjerë, që mund të jenë rekrutues të viktimave seksuale.

Rekrutuesit janë njerëz shumë të zellshëm në mashtrimin e viktimave të tyre, duke iu premtuar atyre punësim, shkollim, apo gjëra të ngjashme. Rekrutuesit dinë mirë sesa t'ia rrjetin e mashtrimit, duke iu bërë viktimave llojlloj premtimesh. Pothuajse të gjitha tregimet e vajzave të trafikuar janë të ngjashme. Të gjitha ato janë mashtruar

duke iu premtuar një jetë më e mirë, dhe duke pasur parasysh se shumica prej tyre janë nga vende të varfra dhe se posedojnë një numër të madh problemesh, atyre iu premtohet dhe shuarja e problemeve që ato kanë në vendin e tyre.

Është e njohur botërisht se rrjetet e trafikimit të disa serbëve dhe të disa shqiptarëve kanë bashkëpunim në këtë fushë të krimit. Ekzistojnë kanale të trafikimit që përfshijnë Beogradin, Prishtinën, Tiranën dhe pastaj shtrihen në tërë botën. Por ata që udhëheqin këtë rrjet janë shqiptarët dhe serbët, dhe sipas disa statistikave ata nxjerrin fitime prej 1.5 milion dollarë amerikanë brenda një jave. Shihet, pra, se industria e skllavërisë seksuale po lulëzon dhe prej saj nxirret një përfitim jashtëzakonisht i madh. Edhe pse ekziston një urrejtje e madhe mes shqiptarëve dhe serbëve, kriminelët bashkëpunojnë me njëri tjetrin në një tregti fitimprurëse për të dyja palët.

Policia vendore, nga 1 janari deri në fund të dhjetorit 2006, ka kontrolluar gjithsej 1285 lokale, prej të cilave 21 janë mbyllur për arsye tanimë të njohura. Aktualisht ekziston një numër i madh lokalesh të dyshimta për prostitucion, që tanimë policia vendore i ka futur në listë.

Në komunën e Prizrenit ekzistojnë 59 lokale, pastaj prin Peja me 27, më pas vazhdon Gjilani me 18 lokale të tilla, Ferizaj me 13, Prishtina me 12, si dhe qyteti i Mitrovicës me 10 lokale të tilla.

Aktualisht në Kosovë nuk ka ndonjë rregull ligjor që ndalon apo që edhe e legalizon këtë profesion, edhe pse në kohën e Bernard Kushnerit, ish kryeshafi i UNMIKUT, ekzistonte një ligj që i ndalonte dhe i dënonte personat që merreshin me këtë veprimtari të paligjshme. Si duket tani ky ligj nuk po përfillet më.



Reflektime ndërkombëtare për Kosovën

## KOSOVA RIKTHEHET NË KRYE TË VËMENDJES NDËRKOMBËTARE

Demir RESHITI

Prezantimi i shumëpritur i “pakos” së kryendërmjetësit ndërkombëtar për statusin e Kosovës, Martti Ahtisaari, është përcjellë me shumë interesim jo vetëm nga qarqe zyrtare ndërkombëtare, por edhe nga mediat të cilat janë fokusuar



në përmbajtjen e këtij propozimi, dhe reagimet në Beograd dhe Prishtinë. Kjo, e ka rikthyer Kosovën në krye të vëmendjes ndërkombëtare. Deklarata në mbështetje të propozimit të Ahtisaarit kanë dhënë përfaqësuesit e shteteve anëtare të Grupit të Kontaktit, pastaj Bashkimi Evropian dhe NATO-s. Ahtisaarin e kanë mbështetur edhe zyrtarë të lartë të vendeve evropiane, të cilët kanë vlerësuar se ky propozim paraqet një plan serioz për zgjidhjen përfundimtare të statusit të Kosovës dhe hapjen e perspektives së integritetit të rajonit të Ballkanit në Bashkimin Evropian. Në vazhdim po e paraqesim një kronologji të ngjarjeve dhe deklaratave më të rëndësishme lidhur me Kosovën, në periudhën janar - shkurt 2007.

**(15 janar) SHBA-ja dhe NATO me qëndrim të përbashkët për Kosovën**

**Bruksel:** Sekretari i përgjithshëm i NATO-s, Jaap de Hoop Scheffer ka biseduar për Kosovën me sekretarin amerikan të mbrojtjes, Robert Gates, me ç'rast kanë shprehur qëndrim të përbashkët se duhet të gjendet zgjidhje e statusit të Kosovës sa më shpejtë që të jetë e mundur, ndërsa KFOR-i gjatë tërë procesit duhet ta mbajë forcën në nivel të tashëm.

**(16 janar) Petritsch: Kosova do të fitojë pavarësi të kushtëzuar**

**Vjenë:** Kosova do të fitojë pavarësi të kushtëzuar. Kështu është shprehur për

gazetën vjeneze “Kourier” ambasadori austriak në OKB, Wolfgang Petritsch, duke nënvizuar se ajo do të jetë nën administrimin e Bashkimit Evropian.

**Moskë:** Çfarëdo zgjidhje për statusin e ardhshëm të Kosovës duhet të jetë e pranueshme edhe nga Beogradi dhe nuk do të duhet të imponohet nga fuqitë e jashtme, ka deklaruar ministri i Jashtëm rus, Sergei Lavrov.

**Londër:** Nënkyetari i Senatit të Mbretërisë së Belgjikës, Staf Nimmegeers, në një intervistë për radion BBC, ka thënë se është hapur dera e pavarësisë së Kosovës, duke shtuar se vendi i tij ka një mision që ta bashkojë Evropën në pikëpamjen për Kosovën e pavarur.

**Bruksel:** Komisioneri i BE-së për zgjerimin Oli Rehn ka thënë se zgjidhja



për statusin e Kosovës duhet të jetë politikisht dhe legalisht e qartë, dhe të mundësojë marrëdhënie kontraktuale ndërkombëtare. Ai ka theksuar se çështja e statusit të Kosovës është rast i veçantë dhe nuk paraqet precedencë.

**(17 janar) Strasburg:** Bashkimi Evropian me masa përcjellëse do ta shoqërojë zbatimin e zgjidhjes së statusit të Kosovës, ka deklaruar në Strasburg kancelarja gjermane Angela Merkel, gjatë shpalosjes së programit gjashtëmujor të kryesimit të Gjermanisë me BE-në.

**(18 janar) Steinmeier: Stabilitet në Kosovë mund të ketë vetëm nëse shqiptarët pranojnë zgjidhjen**

**Berlin:** “Propozimi i Ahtisarit do të përmbajë edhe ndalimin e bashkimit të Kosovës me Shqipërinë dhe me pjesët e

shteteve të tjera”, ka deklaruar koordinatori i Paktit të Stabilitetit për Evropën Jugindore Erhard Busek për botimin gjerman të gazetës “Financial Times”.

**(19 janar) Merkel: Statusi sipas vullnetit të qytetarëve të Kosovës...**

**Berlin:** Vendimi për fatin e Kosovës duhet ta ketë pëlqimin maksimal të qytetarëve të Kosovës, por pa shkaktuar trazira në Serbi, ka deklaruar të premtën për agjencinë “Reuters” kancelarja gjermane Angela Merkel.

**(21 janar) Putin: Zgjidhja për Kosovën nuk guxon të imponohet**

**Moskë:** Kryetari i Rusisë, Vladimir Putin, pas bisedës me kancelaren gjermane, Angela Merkel, ka deklaruar se vendi i tij do ta mbështesë propozimin ndërkombëtar për statusin final të Kosovës, vetëm nëse ai do të jetë i pranueshëm për të dy palët.

**(23 janar) Solana hedh poshtë mundësinë e vetos së Rusisë**

**Bruksel:** Shefi i politikës së jashtme dhe sigurisë i Bashkimit Evropian, Javier Solana, ka hedhur poshtë kërcënimin e Rusisë për përdorimin e vetos ndaj rezolutës së Kombeve të Bashkuara për statusin e ardhshëm të Kosovës. “Ne presim që negociatat të udhëhiqen në atë mënyrë që rezoluta të miratohet në një kurs përkatës, por në çfarëdo rasti pa veto”, ka thënë Solana në një konferencë për media në Bruksel.

**Bruksel:** “Është herët të mendohet për rezolutë të re të Këshillit të Sigurimit të



OKB-së për Kosovën”, ka deklaruar në Bruksel shefi i diplomacisë evropiane Javier Solana, pas takimit me sekretarin e përgjithshëm të Kombeve të Bashkuara, Ban Ki-moon, me të cilin kanë biseduar

për çështjen e statusit të Kosovës.

**(25 janar) Ahtisaari ia ka prezantuar propozimin kreut të OKB-së**

**Bruksel:** I dërguari i posaçëm i OKB-së për statusin e Kosovës, Martti Ahtisaari i ka paraqitur të enjten në Paris sekretarit të Përgjithshëm të OKB-së, Ban Ki-Moon propozimin e tij për statusin final të Kosovës.

**Uashington:** Shtyrja e vendimit për statusin e Kosovës do të ishte me të vërtetë një pengesë për mbarë rajonin, për qytetarët e Kosovës, për Serbinë dhe gjithashtu për fqinjët, ka deklaruar në një intervistë për "Zërin e Amerikës" ndihmësekretarja amerikane e Shtetit, Rosemary DiCarlo.

**(26 janar) Ahtisaari ua prezanton propozimin përfaqësuesve të GK-së**

**Vjenë:** I dërguari i posaçëm për statusin e Kosovës Martti Ahtisaari, në Vjenë, ua ka prezantuar përfaqësuesve të vendeve anëtare të Grupit të Kontaktit propozimin e tij për statusin final të Kosovës.

**(28 janar) Polt: SHBA-ja dëshiron zgjidhje të qartë**

**Uashington:** Shtetet e Bashkuara të Amerikës do të mbështesin një zgjidhje në harmoni me faktet e veçanta që kanë të bëjnë me Kosovën dhe gjendjen në terren, ka deklaruar, në konferencën ditore të shtypit, zëdhënësi Departamentit të Shtetit, Sean McCormack.

**(29 janar) Scheffer: Aleatët e NATO-s e mbështesin propozimin e Ahtisaarit**

**Bruksel:** "Aleatët e NATO-s e mbështesin propozimin që presidentit Ahtisaari do ta paraqesë të palët më 2 shkurt", ka deklaruar sekretari i përgjithshëm i aleancës veriatlantike, Jaap De Hoop Scheffer.

**(30 janar) - Solana: Zgjidhja për Kosovën të jetë në favor të stabilitetit**

**Bruksel:** Plani për statusin e Kosovës duhet të jetë i përfunduar deri në fund të



muajit shkurt, në mënyrë që t'i paraqitet Këshillit të Sigurimit. Kështu ka deklaruar të martën në Bruksel shefi i

diplomacisë së BE-së, Javier Solana, duke shtuar se zgjidhja për Kosovën duhet të jetë në favor të stabilitetit.

**(31 janar) - Lagendijk: Pavarësia e vetmja zgjidhje për Kosovën**

**Berlin:** "Pavarësia është e vetmja zgjidhje për Kosovën", ka thënë eurodeputeti holandez, Joost Lagendijk, në një intervistë për të përditshmen gjermane "Die Tageszeitung".

**(1 shkurt) "Reuters": As pavarësi për Kosovën as sovranitet të Serbisë**

**Londër:** As pavarësi për Kosovën as sovranitet të Serbisë, nuk përmban propozimi i të dërguarit të posaçëm të OKB-së, Marti Ahtisari. Këtë e ka njoftuar agjencia Reuters, sipas të cilës propozimi përmban dispozita të cilat nëse i miraton Këshilli i Sigurimit të OKB-së, do t'i mundësojnë shumicës shqiptare që të fitojë pavarësi, si dhe pranim të Kosovës prej disa shteteve të caktuara.

**(2 shkurt) Ahtisaari dorëzon "pakon" në Prishtinë dhe Beograd**

Prezantimin e shumëpritur të "pakos" nga ana e kryendërmjetësit Ahtisaari është pershendetur nga qarqe më të rëndë-



sishme ndërkombëtare, duke filluar nga SHBA-ja, BE-ja, Grupi i Kontaktit, NATO-ja, Britania e Madhe, Franca, Suedia, Shqipëria, Belgjika, etj. Kosova këtë ditë ka qenë temë qendrore nëpër mediumet botërore.

**(4 shkurt) Lavrov: Rusia dhe SHBA me qëndrime të kundërta për Kosovën**

**Moskë:** "Rusia dhe SHBA-ja edhe më tutje kanë mospajtime të thella rreth ardhmërisë së Kosovës", ka deklaruar ministri i jashtëm rus Sergei Lavrov, për agjencitë ruse të lajmeve pas një vizite në SHBA.

**(5 shkurt) Rohan prezantoi pakon e Ahtisaarit para BE-së**

**Bruksel:** Shumica e vendeve të BE-së, me përjashtim të Greqisë, e kanë

mbështetur dokumentin me propozimin e kryendërmjetësit Marti Ahtisaari, të cilin të hënën zyrtarëve të unionit ua ka paraqitur zëvendësi i Ahtisaarit, Albert Rohan.

**Bruksel:** Kryetari Asamblesë parlamentare të NATO-s Bert Koenders ka përshëndetur Ahtisaarin për zgjidhjen e statusit të Kosovës. Koenders ka shprehur bindjen se "dispozitat kushtetuese, ekonomike, dhe të sigurisë të propozimit janë vërtet të drejtuara në drejtim të zhvillimit multietnik, demokratik dhe prosperitetit të Kosovës".

**(6 shkurt) - Blair: "Është shumë e qartë se çfarë do populli i Kosovës"**



**Londër:** "Në këtë moment, nuk do të doja të jepja mendimin tim për statusin final, por mendoj se është shumë e qartë se çfarë do populli i Kosovës", ka thënë kryeministri britanik, Tony Blair duke shtuar se politika ndërkombëtare po shkon drejt ofrimit të një shkalle më të lartë të pavarësisë për Kosovën.

**(8 shkurt) Scheffer: NATO do të vazhdojë të përkujdeset për sigurinë në Kosovë**

**Seville:** "NATO do të vazhdojë ta kryejë detyrën thelbësore të krijimit të një mjedisi stabil dhe të sigurt", ka theksuar në hapje të samitit të ministrave të mbrojtjes të vendeve anëtare të NATO-s, në Seville të Spanjes, sekretari i përgjithshëm i kësaj organizate, Jaap De Hoop Scheffer.

**Uashington:** Sekretarja amerikane e Shtetit Condoleezza Rice ka deklaruar se SHBA-ja mbështet një zgjidhje të shpejtë të statusit të ardhshëm të Kosovës.

Ajo ka thënë se mbështetja eventuale e Uashingtonit për pavarësinë e Kosovës nuk do të thotë se njëkohësisht do të mbështesë edhe shkëputjen e rajoneve autonome ruse në Kaukaz.

**(9 shkurt) Beogradi me kërkesa të reja**

**Beograd:** Autoritetet e Beogradit, përveç kërkesës për shtyrjen e konsultave të Vjenës, kanë dërguar edhe një kërkesë shtesë që të ndahet pjesa statusore, përkatësisht pjesa juridiko-politike nga ajo teknike e propozimit të Ahtisaarit për Kosovën.

Bukuritë natyrore të Kosovës

## GJERAVICA, MOUNT EVEREST-I I KOSOVËS

**Maja e Gjeravicës me 2656 metra lartësi mbidetare është maja më e lartë në Kosovë. Ajo është pjesë e Alpeve Shqiptare të Kosovës (Bjeshkëve të Namuna).**

Osman D. GASHI



Vendndodhja:  
Koordinatat gjeografike në shkallë, minuta dhe sekonda

Latitude : 42 31' 58"  
Longitude: 20 08' 25"

Gjeravica është maja më e lartë e Kosovës, që ka një lartësi prej

2656 metrash mbi nivelin e detit, dhe përfshihet në malet e Alpeve Shqiptare të Kosovës, apo si quhen ndryshe Bjeshkëve të Namuna, shumë afër kufirit me Shqipërinë, dhe vetëm pak larg kufirit me Malin e Zi.

### ALPET SHQIPTARE TË KOSOVËS APO BJESHKËT E NAMUNA

Janë vargëzim kreshtash malore dhe është zona më e lartë e Kosovës, me lartësi 2400-2500 metra mbi nivelin e detit, me gjatësi 5-7 km, shtihen në skajin perëndimor të Rrafshit të Dukagjinit dhe të Kosovës. Disa nga majat e larta janë: Zhlljebi (2380 m), Hajla (2400 m), Shtedimi (2272 m), Peklena (1376 m), Koprniku (2160 m), Bjeshka e Strelleit (2377 m), Bjeshka e Lumëbardhit (2522 m), Liqinati (2341 m), Juniku (2265 m), etj.

Gjeravica ka një pasuri të rrallë të florës dhe faunës, është e pasur me ujë, me një

numër të madh kullosash dhe atraksione të tjera natyrore për zhvillimin e turizmit dhe të sporteve të ndryshme. Ky mal shtrihet prej qytetit të Deçanit. Një qytet tjetër afër të cilit ndodhet kjo majë e lartë

turistët e mundshëm, që duan ta vizitojnë këtë vend të bukur. Rruga për në Gjeravicë nuk është lehtë për t'u gjetur. Nëse e ndiqni Lumëbardhin e Deçanit, i cili ka rrugica anësore, do të humbisni



është edhe qyteti i Pejës. Deçani është 16 km në jug të tij.

Turizmi nuk është i zhvilluar, nuk ka hotele, apo vende ku mund të vendosen

rrugën. Por e mira është që banorët lokal do tu rrëfejnë rrugën në mënyrë që të arrini atje.

Ju duhet të ndiqni Lumëbardhin e Deçanit






vetëm ca qindra metra larg prej Manastirit të Deçanit. Një shteg i lehtë në vargmalin mbi luginë, që është territor i dendur dhe i pyllëzuar me drunj, do t'iu dërgoj juve në Gjeravicë pas 3 orë udhëtimi në toka alpine ku do të hasni në shumë shtëpi që janë të ndërtuara prej druri, të cilat shërbejnë si kasolle për t'u strehuar barinjtë. Kur kaloni vendbanimin e parë do të shihni një kasolle të madhe malore (në 2000 metra mbi nivelin e detit) mbi ujëvarë. Kushtet e kasolles nuk janë edhe aq të sigurta. Prej aty është një rrugë kacavjerrëse dhe e vështirë 3 orëshe për në Gjeravicë.

Gjeravica (2656 m) është një majë e lehtë. Ka një gjeologji prej shkëmbinjve gëlqerorë, për dallim nga malet qendrore të Bjeshkëve të Namuna që përbëhen nga shëmbinj metamorfik.




Maja e Shkelzenit (2407 m) dhe Liqeni i Zembrës

Bora në muajin qershor në Gjeravicë



Flora dhe fauna në Bjeshkë të Namuna



## Lufta në Irak

# AKTORËT DHE PËRFITUESIT E KRIZËS IRAKIANE

Si në çdo luftë edhe në rastin e luftës së Irakut mund të flitet për aktorët dhe përfituesit e krizës së saj. Analistë të shumtë arabë me rastin e krizës irakiane nuk rreshtin së akuzuari grupin neo-konservator amerikan. Ndërkaq, një pjesë e konsiderueshme e analistëve amerikanë dhe perëndimorë akuzojnë radikalistët islamikë. Kurse disa analistë të tjerë mendojnë se këto grupe e kanë shkaktuar së bashku rrëmujën e sotme, dhe kjo ua ka kthyer politikanëve influencën dhe autoritetin.

### Ajni SINANI

Ajo që bie në sy për njohësit e mirë të situatës irakiane, është se shumë pak raporte, që bëhen për krizën irakiane, i kushtojnë vëmendje asaj se kush janë ata që paraqiten nga “hija” dhe gjuajnë në të dy anët. Analistët tërheqin vërejtjen se pak përqendrohet vëmendja tek fakti se janë gjithnjë grupet e njëjta që nxisin kaos. Perandoria Britanike pjesën më të

vrasjeve masive dhe të tmerrshme në Irak bëhen nga ana e disa lojtarëve të “jashtëm”. Qarqe të caktuara që duan ta shkatërrojnë Irakun janë të interesuara t’i ngatërrojnë sunitët dhe shitët, dhe kjo mundësisht të shtrihet edhe më gjerë.

#### **Kush i gëzohet kaosit në Irak**

Grupi i parë, që dëshiron që kaosi të vazhdojë në Irak, sipas shumë analistëve

protestantë dhe Bushi kanë kohë që kanë kërcënuar se Siria dhe Irani do të jenë në shënjestër të sulmit të ardhshëm nga ana e SHBA-ve. Një retorikë e tillë ndaj Sirisë dhe Iranit, vlerësojnë ata, i ka dhënë arsye të plotë Iranit dhe Sirisë që të synojnë që SHBA të mbahet dhe të dërmohet në Irak, sa më shumë që të jetë e mundshme.

#### **Partia Likud-e në Izrael**

Edhe pse sipas disa sondazheve shumica e izraelitëve e duan paqen, vazhdimi i një situatë kaotike në Irak i ofron qeverisë Likud-e një justifikim për politikën e saj arrogante dhe hegjemone. Ka shumë fakte që provojnë implikimin direkt të Izraelit në krizën e Irakut. Vazhdimisht theksohet se agjentët izraelitë janë shumë aktivë me kurdët, madje edhe i stërvitin për luftë. Bëhet me dije se edhe forcat pushtuese amerikane, kanë sjellë çifutë që t’i mësojnë ushtarët amerikanë se si ta mposhtin rezistencën arabe.

Një fakt tjetër është se Izraeli, në fushë-betejën irakiane, mund të fus në lojë, pa u vërejtur gjithaq, arabët e saj.

#### **Kompanitë e armëve**

Të flitet për luftën dhe të anashkalohen kompanitë e mëdha që prodhojnë armë do të ishte shumë naive. Kompanitë e armëve jo vetëm që fitojnë gjatë zhvillimit të luftërave, por shpesh ato ndikojnë edhe në fillimin dhe vazhdimin e tyre. Me rastin e Irakut ato çdo ditë fitojnë me miliona dollarë, duke u shitur armë madje edhe palëve të kundërta. Kompanive të armëve gjithsesi u përshtaten situata të tilla.

#### **Lobi Armagedon**

Ndër ata që janë të interesuar që kaosi të zgjasë sa më shumë që është e mundshme, padyshim se është lobi Armagedon. Besimtarët dhe qarqet fanatike protestante, kaosin në Irak e shohin si ndihmë për realizimin e fantazisë së tyre në sendërtimin e “premtimit Hyjnor”.

Protesta kundër luftës në Irak



madhe të platformës së saj të politikës kolonialiste e kishte ndërtuar mbi raportet ndërmjet fiseve. Ajo duke favorizuar dhe duke u dhënë pushtet disa fiseve kundrejt të tjerave, kishte bërë që fiset arabe shpesh të urrenin njëra-tjetrën më shumë se pushtuesin e huaj. Historia ka dëshmuar se në një shoqëri fisnore, siç është edhe sot e kësaj dite shoqëria irakiane, është shumë e lehtë që fiset të nxiten në luftë ndërmjet tyre, ngase ato kanë një të shkuar plot padrejtësi dhe mezi presin rastin që të hakmerren.

#### **Aktorët e jashtëm në lojën irakiane**

Nuk ka fare dyshim se në Irak janë të involvuar shumë aktorë të jashtëm. Nuk është e vështirë të kuptohet se shumë prej

arabë dhe të huaj është Al Kaida. Çdo pamje ku amerikanët vrasin arabët, sipas tyre, është një ndihmesë e drejtpërdrejtë për Bin Ladenin. Kësaj situatë i gëzohen edhe gjithë ata që duan ta shohin SHBA-në të poshtëruar dhe të dobësuar në batakun e luftës së Irakut. Me këtë rast nuk duhen harruar as rusët që nuk janë gjithaq të dhënë miqësisht ndaj SHBA-së, dhe kinezët. Madje, kinezët janë paralajmëruar një herë se mund të jenë në radhë, kur SHBA-ja të mbarojë punë me botën islame. Si kundërpërgjigje ndaj këtij paralajmërimi mund të merret edhe armatimi i vazhdueshëm i Kinës.

#### **Fqinjët irakianë**

Analistët kujtojnë se neo-konservatorët

Veshja dhe identiteti

## **NDRYSHIMI I VESHJES PARALAJMËRON EDHE NDRYSHIMIN E VETË KULTURËS**

**Veshja e çdo njeriu paraqet një flamur të vendit të qenies së tij, të cilin ai e ka ngritur para godinës së qenies së vet dhe me të cilin ai dëshiron të potencojë se cilës kulturë i përket.**

Emine VEZAJ

Njerëzit krenohen me shumë gjëra, e ndër to kultura e veshjes zë një vend tejet të veçantë. Fenomeni i veshjes e përshkon pothuaj tërë historinë e njerëzimit dhe është i përhapur në mbarë hapësirën gjeografike të rruzullit tokësor. Në bazë të hulumtimeve që janë bërë nga gjenerata në gjeneratë, hulumtues të ndryshëm kanë konstatuar se veshja përmbush tri nevoja të njeriut, së pari, mbron nga të ftohtit dhe të nxehtit; së dyti, ndihmon në ruajtjen e nderit dhe turpit të njeriut; dhe së treti, bën që njeriu të duket i bukur, i rregullt, serioz dhe dinjitoz. Por veshja nuk mund të

shpjegohet vetëm përmes këtyre tre parametrave. Ajo është e ndryshme ndërmjet gjinive dhe shtresave të ndryshme të shoqërisë. Dallimi mund të vihet re edhe nga veshja e një zonje qyteti, kundrejt një zonje nga një mjedis rural. Por, mund të thuhet se njerëzit komunikojnë me anën e veshjes dhe secili e prezanton veten me gjuhën e rrobave që ai bart, pra se kush është, prej nga vjen, dhe se cilës kulturë i përket. Veshja e çdo njeriu paraqet një flamur të vendit të qenies së tij, të cilin ai e ka ngritur para godinës së qenies së vet dhe me të cilin ai dëshiron të potencojë se cilës kulturë i

përket. Thënë më shkurt, qëllimi i shqyrtimit tonë në vijim do të mund të përkufizohej si *Veshja në pikëvështrimin historik dhe kulturor në Kosovë.*

### **Veshjet në trevat shqiptare kanë dallime të ndjeshme**

Shtrimi i një studimi tërësor për veshjen popullore, si një ndër komponentët qenësorë të kulturës materiale të një populli në përgjithësi, ose vetëm për veshjen popullore shqiptare në veçanti, me tërë atë larmi të madhe që ka, me tërë ato variante dhe derivate të disa tipave kryesore të veshjes, është një punë e vështirë, do të thosha e pamundur në ntin



e tanishëm të shkallës së njohurive tona etnografike për këtë fushë. Ndryshimet e veshjes gjatë historisë së njerëzimit kanë rrjedhur si pasojë e ndikimit të shumë elementeve natyrore dhe të faktorëve shoqërorë. Këto siç dihet kanë qenë të ndryshme në vise të ndryshme të botës dhe në periudha të ndryshme kohore. Prandaj veshja ka ndryshuar dhe ndryshon varësisht nga ambienti gjeografik, nga koha dhe nga zhvillimi i përgjithshëm historik, ku përfshihen jo vetëm kushtet shoqërore ekonomike, por edhe shija e njerëzve. Po t'i hedhim një

Podrimës, vise me të cilat ai kufizohet. Drenica, Prekorupa (Llapusha), Morava, Gora, Opoja, Llapë, Gollaku etj, kanë disa tipare rajonale në veshjen e tyre, por gjithashtu kanë edhe shumë elemente të përbashkëta. Përveç Rugovës, Dukagjinit dhe Hasit, viset e tjera të Kosovës nuk dallojnë shumë për nga veshja popullore. Sipas Drita Statovcit veshja e grave të Hasit, duke mos përzier Malësinë e Gjakovës, paraqet një variant të veçantë dhe tipologjikisht i takon veshjes me këmishë të gjatë me dy futa. Këtu përshtjellakët s'janë të zymtë, por

pubertetit, pushonte prerja e flokëve dhe ato liheshin të rriteshin normal. Gjatë gjithë kohës së mbajtjes së perçes, përkatësisht gjer në moshën e pubertetit, vajzat bënin vetëm përshtjellakun e parë, gjersa me të hyrë në këtë moshë, fillonin të bëjnë edhe përshtjellakun e prapmë. Kujdes i kushtohej edhe rregullimit të saj me gjithë aksesorët e tjerë... Edhe veshja e grave, sidomos e nuseve, paraqet veshjen më të pasur, si në planin struktural-morfologjik, ashtu edhe në atë ornamentik e dekorativ. Si pjesë përbërëse të kësaj veshjeje mund të përmendet kapuçi me pare, marhama, këmisha e pëlhurës e gjatë gjer në fund të këmbëve me jakë të vogël, përshtjellakët, jeleku, zhguni, gëzofi, çorapët, opingat. Përgjithësisht veshja e grave e grupmoshave të ndryshme, në planin tipologjik, nuk paraqet dallime, struktura e saj është e njëjtë.

Tradita e veshjes shqiptare në veprën e një autori kroat, Lovro Mihaçević (prift katolik i lindur në Kreshevë, në Bosnje, që ka qëndruar në mesin e shqiptarëve me detyrë fetare plot 14 vjet) përshkruhet kështu: "Edhe veshja e grave është e ndryshme, por zakonisht veshin fustan të zi të gjatë, të cilin me një shokë e shtrëngojnë në brez, e në krye mbajnë shaminë e bardhë."

Shohim se edhe veshja tradicionale shqiptare e grave ka paraqitur një mbulim të tërë trupit në mënyra të ndryshme, herë me fustane të gjatë, e herë me dimia, bile edhe mbulimi i kokës ka qenë i pranishëm, siç e pamë, herë me kapuç, e herë me maramë. Pra, në përgjithësi, gati e tërë femra ka qenë e mbuluar. Sidoqoftë, me këtë nuk duam të themi se veshja ishte islame. S'do mend se kishte disa dallime të thella. Disa nga këto dallime rridhnin nga lidhja e shqiptarëve me besimin islam, por kishte edhe të tilla që kishin rrjedhur nga besimi krishtero-ortodoks.

Historia e viteve të fundit në Kosovë dëshmon, në të vërtetë, mohimin e vlerave kombëtare dhe fetare, po ashtu dëshmon edhe humbjen e autencitetit burimor të veshjes në aspektin tradicional dhe fetar. Gjithmonë ndryshimi i veshjes ka paralajmëruar dhe ndryshimin e vetë kulturës, pasi është e ditur se njeriu nuk mund t'i kthejë shpinën kulturës së vet derisa të mos e hedhë veshjen e vet, dhe se nuk fillon ta bartë veshjen e huaj, derisa të mos e pranojë kulturën e atij populli të huaj. Prandaj thuhet "me kë rri, i tillë je", respektivisht, njeriu i përket atij, veshjen e të cilit bart.



vështrim të shkurtër veshjes në trevat shqiptare do të shohim se ajo ka dallime në rajone të caktuara. Këtu do të përmendim veshjet që janë identifikuar më tepër të shqiptarët e Kosovës.

Veshja popullore e Rrafshit të Dukagjinit (rrethet e Pejës dhe të Gjakovës), sidomos ajo e grave, është shumë karakteristike dhe origjinale. Këtu të bie në sy më parë këmisha e gjatë (e grave) e pëlhurës së vegjës me vija të trasha e të rralla vertikale (të zeza ose ngjyrë kafe), pastaj përshtjellakët me ngjyrë të mbyllur e të qëndisur, çorapet e leshta të zeza deri në gjunjë, mitani i pambukut me mëngë, i zbukuruar me gajtan me copa cohe, dhe në kokë lidhëse e marhama. Sipas këtij autori, edhe veshja e Hasit nuk është shumë më ndryshe krahasuar me veshjen e rajonit të Gjakovës dhe të Pejës, dhe ajo nuk ka shumë ndryshime në strukturën e veshjes.

Veshja e grave të Hasit (zonë kodrinore ndërmjet Gjakovës dhe Prizrenit në anën e djathtë të Drinit të Bardhë) është aq origjinale, saqë gati nuk ka asgjë të përbashkët me veshjen e Dukagjinit e të

kryesisht të ndritshëm të kuq. Të pasmin e quajnë "pshtallak", kurse të përparmin "kanac" e "bohçe".

Veshja e grave të Drenicës përfaqëson një variant të veçantë të veshjes me dy futa, të cilën këtu vendaset e emërtojnë me "veshë pëstallaku". Kjo është shumë më e pasur se ajo e Rrafshit të Dukagjinit, e në disa raste edhe se ajo e Hasit.

Në Llap dhe në Moravë veshja popullore e grave u ruajt deri në Luftën e Dytë Botërore. Sot nuk mund të gjendet, pasi është zhdukur plotësisht. Një variant të veçantë paraqesin veshjet e grave të Jablanicës dhe të trevës së Gollakut. Këtu hasim në dimi të leshta ngjyre të mbyllur, zakonisht të zezë, të cilave për mënyrën e qepjes së tyre u thonë "dimi me gurra" ose "t'gurrume".

### **Veshja tradicionale shqiptare e grave ka paraqitur një mbulim të tërë trupit**

Edhe pse për veshjen e vajzave nuk mund të bëhet fjalë si për një tip të veçantë të veshjeve, krahasuar përgjithësisht me veshjen e grave shihen disa transformime morfologjike e strukturale të veshjeve në këtë moshë. Me të hyrë në fazën e

Histori islame

## THIRRJA PUBLIKE DHE PERSEKUTIMI

**Propaganda e madhe bëri që në mbarë Gadishullin Arabik, dhe më gjerë, të përhapej fjala se në Mekke ishte një “magjistar i përbuzur”. Talljet, persekutimet dhe gjenocidi nuk kishin të ndalur. Së fundi, muslimanët të penguar që të jetojnë në Mekke, detyrohen të shpërngulen...**

**Tani, kjo thirrje, përveç që prek interesat e sipër theksuara, lufton sistemin bankar që me anën e kamatave po i skllavëron shtetet e varfra.**

Muhamed Jusufi - KAJOLLI



Pas plot tri vjet thirrje ilegale, Muhammedi s.a.v.s. u urdhërua nga i Madhërishti që tani e tutje thirrjet t'i bënte në legalitet. Muslimanët të

entuziazuar dolën në qendër të Mekkes për ta thirrur njerëzimin në fenë që këshillonte të besojë vetëm Një Zot dhe që të Atij mos i shoqërohej asgjë tjetër, në asnjë formë. Secili prej tyre shkoi fillimisht t'i thërriste të afërmit e tyre.

Edhe Muhammedi s.a.v.s. veprroi kështu, sepse ai ishte urdhëruar nga i Madhërishti që ta fillonte thirrjen e tij nga familja e tij e ngushtë. Pra, nga xhaxhallarët dhe fëmijët e tyre. Ftesa e tij i bënte thirrje farefisit të tij që të mblidhej në kodrinën Safa (vend i njohur për të gjithë haxhilerët). Para se t'ua tregonte qëllimin e ftesës, ai ju tha: “O familja ime, sikur t'iu them se në anën tjetër të këtyre kodrave, do të na sulmojë një armik me një numër të madh kalorësish, dhe se së shpejti do të masakrohem, a do të më kishit besuar?” Ata njëzëri i thanë: Po! Ata asnjëherë nuk kishin qenë dëshmitarë të ndonjë gënjeshtre sado të vogël të Muhammedit s.a.v.s., prandaj edhe nuk e vunë në dyshim thënien e tij. Meqenëse e aprovuan besnikërinë e tij, ai iu tha: “Beto hem në Atë që më ka dhënë shpirtin, se unë jam i dërguar i All-llahut dhe ju ftoj t'i besoni All-llahut Një, të Vetëm, dhe të Pashoq”. Ebu Lehebi ishte i pari që iu përgjigj me arrogancë: 'I mjeri ti, a për këtë na paske ftuar?' Me kaq tubimi familjar mbaroi sepse Ebu Lehebi ishte këmbëngulës që këto fjalë nuk janë të vërteta, dhe se rrjedhin prej një “gënjeshtari” dhe “falltari”. Pas kësaj arrogance nga ana e tij, All-llahu zbriti

kaptinën (Suren) e 111-të.

### Persekutimi

Dalja e tyre publike nuk iu doli muslimanëve ashtu siç e kishin menduar. Ndoshta të mbështetur tek Pejgamberi s.a.v.s., ata nuk kishin menduar se do të hasnin në pengesa, por ju doli e kundërta. Thirrja islame nuk ishte e ngjashme sikurse ajo e pejgamberëve të tjerë të më hershëm të All-llahut, sikur thirrja e Isait, Musait, Ibrahimit, Nuhut, etj. Në një ajet kur'anor i Lartmadhërishti u përkujton se në xhennet nuk hyhet pa u sprovuar mirë. Forma e thirrjes në Islam ishte krejt ndryshe. Më vonë u kuptua se kjo thirrje, ishte mbarë njerëzore, dhe se kjo thirrje, nuk i përkiste vetëm një periudhe kohore. Thirrja islame ndryshonte rrënjësisht, sepse tani kemi të bëjmë me një thirrje specifike e që



do të jetë këshilluese për të gjitha gjeneratat që do të vinin, deri në ditën e fundit të njerëzimit. Kjo thirrje ishte gjithëpërfshirëse, prandaj mesazhet hyjnore që përcillte Muhammedi s.a.v.s. dhe pasuesit e tij, fillimisht të pakët, sa ishin tërheqëse për një grup, aq ishin edhe tmerruese për grupin tjetër, ose për palën sunduese.

Thirrja islame kishte cenuar interesat e shtresave. Kjo thirrje, në çdo kohë dhe në çdo hapësirë cenon interesat e klasës sunduese, në momentin kur ata e

spostojnë anash interesin e përgjithshëm universal. Islami, është i vetmi këshilltar, që është ndeshur dhe do të ndeshet me të gjitha strukturat iluzionare. Prandaj, thirrja islame e asaj kohe mund të thuhet se kishte cenuar interesat e poshtë-shënuara të klasës udhëheqëse: 1. Ndryshoi botëkuptimin e robërimit të qenies njerëzore. 2. Ndryshoi botëkuptimin në besimin në shumë zota. 3. U prishën interesat e klasave udhëheqëse. 4. Barazoi skllavin me skllavopronarin. 5. Solli shpjegime të hollësishme dhe bindëse për ringjalljen. 6. Ngriti vetëdijen e gjeneratës së re, se ata nuk janë të detyruar të ndjekin traditat e këqija të baballarëve të tyre. 7. Preku interesat e skulptorëve, të cilët trillonin zota...

Tani, kjo thirrje, përveç që prek interesat e sipër theksuara, lufton sistemin bankar që me anën e kamatave po i skllavëron shtetet e varfra.

### Injorimi dhe tallja

Metodologjia e re, fillimisht krijonte përshtypjen se ishte një ofertë e zakonshme dhe do të jetë afatshkurtër. Kështu e kishte perceptuar elita mekkase deklaratën e muslimanëve. Meqenëse numri i muslimanëve ishte i vogël, parinë mekkase fillimisht nuk e frikësoi prezenca e tyre. Ata i injoruan, dhe nuk kishin pse të merreshin me besimtarët e rinj. Sigurisht që kishin dëgjuar për thirrjet e Muhammedit s.a.v.s. në një Zot të vetëm, por ajo nuk ishte e tmerrshme, sepse në një farë mënyre edhe arabët besonin në një Zot, por për të shkuar deri tek Absoluti, ata mendonin se ju duheshin zota të vegjël ndërmjetësues. Muslimanët, pasi dolën sheshazi, filluan të gëzojnë dhe të fitojnë shumë shpejt respektin dhe simpatinë e masës së thjeshtë. Ata dëgjoheshin me vëmendje, edhe pse në të njëjtën kohë dëgjoheshin edhe talljet e parisë vendore. Muslimanët e kishin kuptuar mesazhin hyjnor, secili

besimtar e kishte kuptuar rolin e tij prej misionari. Në fakt, secili musliman ishte misionar, por për parinë mekkase çdo gjë do të ishte kalimtare. Si duket elita arabe, nuk ishte në gjendje ta kuptonte se arabët do të mund ta braktisnin aq lehtë besimin në shumë zota. Ata nuk e imagjinonin se zotat e tyre do të këmbeshin me një Zot!



Besimi në shumë zota ishte ngulitur thellë në mendjet e arabëve, prandaj shenjat e luhatjes së masës së gjerë ende nuk dukeshin. Prandaj muajt e parë të thirrjes, gjegjësisht në vitin e parë të legalitetit, nuk u ndërмор asgjë serioze, me përjashtim të talljeve spektakulare në drejtim të muslimanëve.

### Ndryshimi i strategjisë

Kur Islami filloi të pranohet nga anëtarët e disa shtëpive, që konsideroheshin familje me autoritet në Mekkë, për herë të parë kërret e fiseve u tubuan enkas për të shprehur shqetësimin e tyre. Në atë tubim nuk mori pjesë axha i Muhammedit s.a.v.s., edhe pse ishte politeist. Në një mënyrë ai konsiderohej mbrojtësi tij, ose më mirë të themi Muhammedi lëvizte lirshëm nëpër qytet në saje të hijes së respektuar të familjes që mbikëqyrte Qaben. Kjo familje gëzonte autoritet të gjerë në mbarë Gadishullin Arabik.

Të tubuarit, u morën vesh njëzëri që të shkojnë te Ebu Talibi, dhe të kërkojnë prej tij që edhe ai t'i bashkohej shqetësimit të tyre. Ebu Talibi nuk e mori vërejtjen e parë si shumë serioze, edhe pse i tha Muhammedit që ta ndërpriste këtë lloj thirrjeje. Përgjigjja që ai i dha, e preku thellë zemrën e Ebu Talibit dhe ai i dha atij mbështetjen e tij të plotë, edhe përkundër faktit se, vetë ai, ishte kundër besimit të tij.

Vizitorët, meqenëse nuk morën përgjigjen e pritur prej tij, vendosën që të ushtronin dhunë ndaj ithtarëve të Muhammedit s.a.v.s. Shtresa më e dobët e vendit, filloi ta përjetojë dhunën. Robërit që kishin pranuar fenë nuk ishin shumë, por, ata që e kishin pranuar fenë, e kishin kuptuar fuqishëm se kishin të bënin me mesazh hyjnor, e assesi me një predikues të rremë. Prandaj në asnjë mënyrë nuk thyheshin. Ndërmjet shumë të torturuarve, Kur'ani iu përkujton besimtarëve vuajtjet e familjes Jasir. Historianët na sjellin edhe shumë familje të tjera, që iu nënshtruan torturave dhe gjenocidit të parisë mekkase, por ne do të mjaftohemi me rastin e robit etiopias, Bilalit.

Familja e Amar ibn Jasirit ishte nën presion dhe torturohej mizorisht. Ndërsa Pejgamberi s.a.v.s. kalonte çdo ditë përreth shtëpisë së kësaj familje, dhe kështu solidarizohej me vuajtjet e tyre. Ai ju thoshte: "Duronit o familja e Jasirit, se takimi ynë është xhenneti". Kjo familje u torturua një kohë të gjatë. I linin pa ushqim dhe pa ujë, por nuk kënaqeshin me kaq. Ata rriheshin me kamxhik çdo ditë nën rrezet e diellit përcëllues. Pas shumë torturave, Amarit i vdes babai, ndërsa nëna e tij u mbyt nga Ebu Xhehli, në momentin kur ajo po e fyente atë gjatë shkuarjes së saj për tek i shoqi i sapo vdekur. Anëtarët e familjes së Jasirit ishin viktimat e para të thirrjes islame. Jasiri numërohet dëshmori i parë nga meshkujt, ndërsa Sumejja dëshmorja e parë nga femrat.

Ebu Bekri, shoku më i ngushtë i Muhammedit dhe Halifi i parë i shtetit musliman, kujton kohën kur kishte kaluar afër Bilalit që po vuante nga torturat e pronarit të tij. Ai dëgjonte fjalën: i Vetëm (ar. Ehad), All-llahu është i Vetëm dhe i Pashoq. Këto fjalë dilnin nga një rob, që kishte mbi gjoks një gur të stërmadh dhe që qëndronte i shtrirë në rërën e nxehtë të Arabisë. I uritur dhe i etur nën rrezet e diellit, myezini i ardhshëm i Muhammedit s.a.v.s. përmendte vetëm fjalën: i Vetëm, i Vetëm. Ebu Bekri kur dëgjoi këto fjalë bëri marrëveshje me pronarin e këtij të persekutuarit dhe e bleu. Atë e dërgoi te Muhammedi s.a.v.s. dhe e liroi nga robëria.

Nga këto sjellje të tyre, mësojmë se mekkasit vepruan në forma të ndryshme kundër muslimanëve. Kjo shpjegon se ata ishin politikanë, por jo edhe vizionarë të mirë. Të gjitha këto i bënin që të kalonin me sa më pak pasoja dhe, njëkohësisht, urrejtja dhe vëllavrasja të mos shtrihej midis familjeve të Mekkës.

Përrshkruesit e jetës dhe veprës së

Muhammedit s.a.v.s. kanë arritur të na japin të dhëna se paria mekkase, sillej ndryshe me tregtarin që kishte pranuar Islamin, ndryshe me personat e fiseve të mëdha të Mekkës, dhe shumë ndryshe me të pastrehët dhe skllevërit.

### Po afrohet koha e haxhit

Meqenëse mesazhi i Muhammedit s.a.v.s. ishte mbarë njerëzor, ai sigurisht që i gëzohej ardhjes së pelegrinëve-haxhilerëve nga mbarë Gadishulli Arabik, ose më gjerë. Ndërsa Muhammedi s.a.v.s. gëzohej, pushtetarët e Mekkës kishin filluar të përjetonin atë vit plot stres dhe ankth. Ata u tubuan disa herë, ashtu siç kishin bërë edhe vitet e mëhershme. Por ky vit ishte i veçantë, sepse diskutimi kryesor ishte sesi të gjenin mënyrën që ta pengonin Muhammedin që të mos dukej gjatë kësaj periudhë kohore të rëndësishme për ta.

Velid ibn el Mugire ju tha të pranishmëve: më duket se nuk kemi rrugëzgjdhje tjetër, përveçse ta njollosim personalitetin e tij. Propozimet që u bënë në tubimin e fundit ishin që atë ta quanin ose falltar, ose psikopat, ose poet ose magjistar. Të gjitha propozimet ishin të papranueshme nga Velidi, sepse sipas tij, Muhammedi nuk dukej të ishte i tillë. Meqenëse nuk trilluan ndonjë njollosje



Taifi

tjetër më të mirë, e që do të ishte e pranueshme për vizitorët, u morën vesh që atë ta quanin magjistar. Sipas tyre ky emërim do të ishte më parandaluesi që vetë pelegrinët t'i afroshin.

Paria mekkase kishte caktuar njerëz në rugët hyrëse të qytetit, që secilit pelegrin t'i tregonin se atë vit ndër anëtarët e familjes së Abdul Mutalibit ishte shfaqur një magjistar. Propaganda e madhe bëri që në mbarë Gadishullin, dhe më gjerë, të përhapej fjala se në Mekkë ishte një "magjistar i përbuzur". Talljet, persekutimet dhe gjenocidi nuk kishin të ndalur. Së fundi, muslimanët të penguar që të jetojnë në Mekkë, detyrohen të shpërngulen.

**Në numrin e ardhëm Migrimet e muslimanëve**

Zhvillime të reja në kompleksin industrial “Feronikeli”

## NË PUNË E MARRË KË TË DUA

**Banorët e fshatit Çikatovë e Vjetër ndjehen të tradhëtuar nga mënyra e privatizimit, ata thonë që “ toka e tyre nuk është pagu siç është premtuar, madje jo vetëm që nuk na kompensohet toka, mirëpo as 10% i të punësuarve të mëparshëm nuk janë rikthyer në vendet e tyre te punësimit.”**

**Bekim DOBRA**

Feronikeli një kompleks industrial, një fabrikë gjigante, tani më e privatizuar dhe blerë nga IMR/Alferon ka filluar të bëjë përgatitjet për rifillimin e punëve. Kudo në shkretore përreth saj dhe në miniera, pas rrethimit të sipërfaqeve dhe objekteve përcjellëse, vërehet rregullimi i infrastrukturës. Tashmë ky gjigant i dikurshëm i ekonomisë së Kosovës jo veç që ka ndërruar pronarin, por edhe emërtimin e këtij objekti, tani më ky objekt industrial në listën e bizneseve, është regjistruar si “ NewCo Feronikeli Complex L.L.C.”

Vlerësuar sipas zhvillimeve të deritashme, hetohen pakënaqësi të mëdha të ish-punëtorëve, te pronarëve të pakomp-

kësaj ane, blerësi i “Feronikel-it” as që ka lodhur kokën! Ata kur kanë filluar punën apo më mirë thënë rifilluar punimet në fabrikë janë përballur me pengesa të reja. Në mesin e afro 350 hektarësh sipërfaqe toke me pasuri minerale, llogaritet që mbi 60 hektarë ende janë të pa komenzuara pronarëve të ligjshëm, kryesisht në Çikatovë të Vjetër. Banorët e këtij fshati për disa herë radhazi kanë ndërpre punën e makinerisë së “NewCo Feronikeli Complex L.L.C” të Kostas Lamnatos, njëri prej disa drejtuesve të këtij kompleksi. Në interesimin e “Spektrit” që të mësoj për shkaqet e këtyre reagimeve, qytetarët e këtij lokaliteti fokusohen në dy prej problemeve

përgjigje se pse nuk kanë përparësi punëtorët vendas dhe ish-punëtorët me rastin e punësimit? Sipas këtyre ish-punëtorëve, drejtori Kostas Lamnatos troç ka thënë u ka thënë se “ Unë në punë e marrë kë të dua se është pronë e imja! Shkoni te Qeveria juaj, se atje e kam blerë...”. Ky delegacion i këtij fshati i ka kërkuar edhe një takim me kryetarin e Komunës së Drenasit Sherif Krasniqi, ata e kanë njoftuar kreun e Komunës së Drenasit se i kanë penguar punimet e punëtorëve të “Feronikelit”, dhe që kërkojnë një zgjidhje sa më të shpejt. Pas gjithë këtyre pengesave nga fshatarët, drejtori i “NewCo Feronikelit Complex L.L.C” Kostas Lamnatos, ju ka thënë fshatarëve të Çikatovës së Vjetër që t'i sjellin fletët poseduese për dëshmimin e pronësisë së tyre! Mirëpo, pikërisht këtu del edhe një pengesë e re, por jo nga kompleksi industrial, por nga pushteti komunal, sepse ende nuk e ka fuqizuar një qëndrim të kahershëm për bashkëpunim me pronarët e rinj të tokës së “Feronikelit. Kryetari i Komunës Sherif Krasniqi, thotë se do të rishqyrtojmë edhe një herë pozicionin e tyre nga organet komunale në raport me “Feronikelin”, por ai është kategorik që të bëhet transparente kontrata e privatizimit dhe që të respektohet prona e qytetarëve dhe kërkesat e ish-punëtorëve për rikthimin në punët e tyre të mëparshme, këtë ai e quan të ligjshme. Por në fund duhet të përmendet edhe fakti se, sipas Drejtorisë për Financa të KK Drenasit nga mosbashkëpunimi me këtë kompani nuk kryhen obligimet tatimore ndaj komunës dhe ende nuk janë definuar kufijtë kadastral të pronave të “Feronikelit” në terren dhe nuk është bërë bartja kadastrale në librat komunal. Mbetet të shihet se si do të rrjedhin zhvillimet e mëvonshme, por në potez është “NewCo Feronikeli Comeplex L.L.C” dhe organet e komunës së Drenasit që ta zhblllokojnë gjendjen.



enzuar për pronat e tyre dhe të pushtetit aktual komunal. Fituesi i tenderit, atëbotë, kishte marrë edhe obligimin që të investoi 20 milion euro këtu, por mbetet te shihet “rahmeti” i pronarëve të rinj të kësaj begatie, sepse sipas deklaratave te deritashme të Kostas Lamnatos, njëri nga drejtuesit e këtij kompleksi, nga 1000 e më tepër punëtor që do të punësohen këtu, sipas politikave operacionale të tenderimit, janë punësuar vetëm 330 punëtor, edhe ata shumica ne baza partiake dhe familjare, kurse një numër shumë i madh i punëtorëve të ma hershëm për momentin jan mbetur jashtë loje. Dihet se është bërë shumë zhurmë dhe pati pro et contra privatizimit dhe shitjes së kësaj pasurie, të vlerësuar si pasuri kombëtare për vetëm 33.001.251 euro.

Pse nuk kanë prioritet punësimi, vendasit...? “ Neve na i morën tokat e mbetëm qiraxhi në tokën tonë”!

Për “zhurmën” e madhe, protestat e reagimet e mëparshme të banorëve të

qendrore; mos pagesën e pronave të tyre të “uzurpuara” siç thonë ata, dhe në mos punësimin e tyre. Kryesisht ndër më të prekurit ndjehen banorët e lagjes Xhemaj, afro 30 familje me 268 anëtarë, ata thonë që në kohën kur “Feronikeli” ka filluar punimet nga kjo lagje u patën punësuar 35 punëtor, kishte familje që kishte dy e tre të punësuar, ndërkaq tash vetëm tre prej tyre janë rikthyer në punë. Banoret e fshatit Çikatovë e Vjetër ndjehen të tradhëtuar nga mënyra e privatizimit, ata thonë që “ toka e tyre nuk është pagu siç është premtuar, madje jo vetëm që nuk na kompensohet toka, mirëpo as 10% i të punësuarve të mëparshëm nuk janë rikthyer në vendet e tyre të punësimit.” Sipas një banori të këtij fshati Ali Morina ish-referent për marrëdhënie pune në “Feronikel” thekson se një delegacion i këtij fshati ka biseduar me drejtorin e “NewCo Feronikeli Complex L.L.C”, Kostas Lamnatos, nga i cili është kërkuar

## Udhëpërshkrim

## NË GJURMË TË GJENIVE

**Fshat me 140 shtëpi, me një xhami të vjetër të djegur në luftë e të lënë shkret, me një xhami të re që punonte si kishat e krishtera, vetëm një ditë në javë të premtën, me një shkollë për të të ardhur keq, kjo ishte Sushica e Tahir Efendi Mulës, babait të Mehmet Akifit, shkrimtarit dhe mendimtarit legjendar shqiptaro-turk të shekullit që shkoi dhe autorit të himnit turk.**

Zekerija IBRAHIMI

Kur të shtunën që shkoi po ngjiteshim rrugës për kufirin e Bllacës për të kaluar në Kosovë, e para që m'u kujtua ishte gjithë ai pezëm a gaz që kishte mundur të ndezë teksti im i javës së kaluar për Bajramin në atë kufi. Mbase dikush më shante a lëvdonte, por mua aspak nuk më vinte lemza. Ku ta dish! Kur vij në këtë kufi doemos më kujtohen edhe ngjarjet e '99-tës, kur si asnjëherë më parë dhe asnjëherë më pas nuk e kam parë aq afër jetën dhe vdekjen. Ishte tmerr, ruana Zot! Megjithatë kufirin e kaluam lehtë dhe kujtimet për Bajramin e Vitit të Ri dhe për ngjarjet e '99-tës u ndërprejnë kur aty pranë kufirit të Unmikistanit (siç kanë filluar ta quajnë me sarkazëm disa Kosovën tonë) na priste makina për të udhëtuar andej. E prej aty posi Dava Gjergji i ramë rreth e për qark Vilajetit. Destinacioni jonë ishte Peja dhe fshati i harruar Sushicë.

Meqë në një mënyrë jam i përfshirë në përgatitjen e veprës madhore "Fletët" të Mehmet Akif Pejanit, kishim vendosur që t'i biem në gjurmë origjinës së këtij vigani. Deri atëherë e dinim se familja e tij e kishte prejardhjen nga fshati Sushicë i Pejës, se babai i tij kishte vajtur në Stamboll kah mesi i shek. XIX dhe nuk ishte kthyer më, por njohuritë tona përfundonin këtu diku. Ndonëse rruga e gjatë, po i binim mespërmes Kosovës, ndërsa rregullat e rrepta të komunikacionit nuk kishe si mos i përfillësh nga gjithë ata policë, megjithatë ishte udhëtim i këndshëm, sa nga muhabeti po aq nga motivacioni që kishim për misionin tonë. Pas më shumë se dy orë udhëtim, arritëm në Pejë e bukur e të vogël e prej aty me udhëzimin e një miku pejan, kthyem rrugë kah Mitrovica. Pra krejt në veri të Kosovës. Edhe pse ishte pak ftohtë dhe ditë e shtunë, ishte për çudi sa pak kishte lëvizje të njerëzve e makinave në atë anë të Kosovës. Në një pjesë të rrugës, derisa po i pyesnim njerëzit se ku është Sushica, e kishim

ndalë një serb, i cili me shumë telashe gjuhësore e bile edhe pak frikë na tregoi shqip se ku ishte ai fshat. Ndërkaq kur kishim qenë më shumë afër fshatit Sushicë dhe prapë u ndalëm të pyesim edhe një herë që të sigurohemi saktë, kësaj radhe ia ngatërruam hesapin një shqiptari kur e pyetëm pa hiri se a di gjë për Mehmet Akifin e Sushicës, babai i të cilit, Tahir Efendiu, kishte vajtur në Turqi dhe kishte vdekur para njëqind viteve. E hutuam njeriun. E pyesnim për gjëra konkrete me shifra qindraveçare dikë që e kishte dertin e traktorit të stërmbushur me kashtë dhe që kujtonte se po talleshim




Poeti i shquar Mehmet Akif Ersoj

me të me këto pyetje. Si duket kishim harruar se njerëzit e atij rajoni më të rëndësishme e kishin bukën e gojës së letërsinë e Mehmet Akifit. Po nejshe, pasioni ynë kishte kaluar edhe këtë fazë. E pasi që i ramë në fije se cila ishte Sushica e Mehmet Akifit, sepse ishin dy, e Epërmja dhe e Poshtmja, kthyem rrugë në Sushicën e Epërme, në një rrugë të paasfaltuar me baltë e të parregulluar. Edhe aty udhëtua boll, nja dy kilometra e kusur. Derisa ecnim aty pari, nëpër ato

rrugë gungaçe, plot baltë dhe pa vërejtur asnjë njeri të gjallë rrugës, njëri nga ne me shpoti tha: "Mbase nuk paska pasur faj Tahir Efendiu që paska ikur këndeje, këtu nuk paska kushte për shkrimtarë". Edhe pse na u duk pak e rëndë kjo, shpejt u bindëm kur u ndeshëm me Sushicën e Epërme të Pejës. Fshat me 140 shtëpi, me një xhami të vjetër të djegur në luftë e të lënë shkret, me një xhami të re që punonte si kishat e krishtera, vetëm një ditë në javë të premtën, me një shkollë për të të ardhur keq, kjo ishte vendlindja e Tahir Efendi Mulës, babait të Mehmet Akifit. Ecëm edhe pak nëpër fshat derisa e gjetëm shtëpinë e kushërinjve të Mehmet Akifit dhe trokitëm në derën e Adem Beqës ose Mulajve, siç njihej në fshat mëhalla e tyre. Plaku 76-vjeçar, Baca Adem, na priti si e ka zakon shqiptari gegë. Na ofroi të hyjmë brenda, por ne meqë edhe ashtu kishim ecur shumë, kishim dëshirë sa më shpejt të marrim atë që na duhej dhe të iknim. I treguam plakut pse jemi aty, për çka atij iu bë shumë qejfi dhe filloi të na e tregojë historinë e mulajve të Sushicës. Kishin qenë 7 vëllezër. Prej tyre Tahiri, babai i shkrimtarit, kishte qenë më i dalluar në mësim, andaj kur në vitin 1850 e kishin ndërtuar atë xhaminë e vjetër e cila u përmend më lart, atë e kishin dërguar në kryeqendrën e Perandorisë që të kthehej t'i shërbente fshatit si hoxhë. Por, Tahiri i ri pasi kishte vajtur në Stamboll dhe ishte bërë alim, e kishte kuptuar se kthimi në Sushicë do të thotë burg për dijen e tij, andaj atje ishte martuar dhe nga ajo martesë e kishte lindur Mehmet Akifin. Fundja në atë kohë kremi i të gjithë shkencëtarëve e njerëzve të ditur ishte tubuar në Stamboll. Mjaftojmë të kujtojmë vëllezërit Frashëri e shumë rilindës të tjerë. Plaku nuk e dinte a kishte ardhur më ndonjëherë Tahir Efendiu në fshat, por thoshte se shkrimtari kishte qenë një herë në Pejë pa e ditur se a kishte ardhur në Sushicë. Dhe, kur në vitin 1936 Mehmet Akifi kishte

ndërruar jetë në Turqi, Baca Adem atëherë kishte qenë vetëm 7-vjeçar (i lindur më 1929). E ishte dëgjuar atëherë rrëfimin për Mehmet Akifin e Tahir Efendiun, se i kishte kushërinj. Më vonë, në kohën e Mbretërisë së SKS-së, nga dhuna në Turqi kishte ikur edhe pjesa tjetër e familjes, ashtu që tash në Sushicë prej asaj loze ishte vetëm Ademi, që i binte të jetë kushëri i dytë i Mehmet Akifit, pra Tahir Efendi u baba i Ademit kishin qenë kushërinj të parë. Megjithatë tani nuk kishin kurrfarë kontakti me ata kushërinj që kishin bërë aq nam në kulturë. E pamë edhe vendin e shtëpisë së vjetër, të pusit e të historisë së shkrimtarit, ndërsa në fund për befasinë tonë, plaku mbasi me shpresë se po e përsëriste historinë e madhështisë së familjes së tij, na tregoi se njërit nga djemtë e tij ia kishte lënë emrin Tahir, ndërsa njërit nga nipat e



Poeti i shquar Mehmet Akif Ersoy

shumtë Mehmet. Por, njerëzit e mëdhenj nuk lindin në vende të vogla. Ata i krijojnë madhështia e mjedisit të tyre.

Para se ta dalim nga Sushica, na ndali edhe një plak dhe na parë se jemi të huaj, na pyeti mos kemi ardhur për të sjellë ndonjë ndihmë ose mos po ua rregullojmë rrugën. Çfarë t'i thoshim këtij plaku?! I treguam se nuk jemi as të Qeverisë e as të Komunës dhe u nisëm.

E kur po ktheheshim këndeje, kur po kalonim nëpër Istog, Pejë, Gjakovë e Prizren, kur po largoheshim gjurmëve të këtij gjeniu të madh të artit letrar, nuk kishte si mos e ndjesh atë afri fizike me këtë kolos dhe njëherit keqardhjen që duke qenë shumë shpesh provincë e qarqeve kulturore e shkencore, shumë rrallë prej nesh burojnë personalitete të këtylla.

Në këtë udhëtim tonin, si për t'u ngushëlluar për humbjen e gjenive, pasardhës të Mehmet Akifit më shumë se në Sushicë takuam në Prizren e Prishtinë. Megjithatë ky truall vazhonte të mbetej pjellor.

## DHEMBJA PERSONALE SI PASOJË E KOHËS REALE

**Kujtesa e kohës në idenë e poetit jepet si mos harrim, kjo vërehet sidomos gjatë përshkrimit të lemerisë dhe tmerrit që ekzistonte. Ndërsa poezitë “Hapësira”, “Adresa e nëmur”, “Zëri i shpirtit”, “Mesnatë”, dhe “Bukuri e nëmur” etj., shprehin filozofinë jetësore, por çdo herë të shprehura dhe të shoqëruara me përshkrimet e vuajtjes së autorit.**  
Sali Bashota, “Bukuri e nëmur”, PEN Qendra e Kosovës, Prishtinë, 2006

### Flamur MALOKU

#### TIPET DISKURSIVE

Për ta njohur në tërësi tekstin “Bukuri e nëmur” të Sali Bashotës, së pari duhet të definojmë tipat e diskurseve, tipat të cilat japin lirikën erotike dhe lirikën meditative. Te lirikat erotike kemi të shënjuar diskursin personal dhe impersonal. Këto lirika funksionojnë në një rrjet tematik, ku temat esenciale që e bëjnë këtë cikël janë: dashuria e humbur dhe e porealizuar e kohës së shkuar, malli, kujtimi, etj. Natyrisht që ky sistem, kërkon një rrjet sistemor leximi. Ndërsa lirikat meditative shpallin një mori mendimesh filozofike nga pozicioni autorial: jeta, vdekja, përjetësia. Këto janë tema universale, por brenda tekstit poetik marrin edhe statusin e idesë socioetike, dhe sociopolitike. Kjo që u tha më lart është teori e nxjerrë drejtpërdrejt nga teksti “Bukuri e nëmur”. Siç thonë kritikët: ekzistenca e letërsisë është që përmes tekstit letrar të nxirret teoria, e përmes teorisë të diferencohet praktika letrare.

#### GJAKIMI PERSONAL

Po e fillojmë interpretimin e tekstit, që nga titulli “Bukuri e nëmur”, që është shenjë initiale e rëndë si për subjektin ligjërues, ashtu edhe për lexuesin. Ky titull metaforik, bart në vete një semiotikë, që shpreh dhe shënjon një gjakim personal. Për autorin, bukuria e nëmur shënjon dhembjen, emocionalitetin, duke formuar brenda vetes skemën: dhembja emocionaliteti subjekti. Ky trinom shtresohet në të gjithë strukturën e tekstit. Kështu duke hyrë në strukturën e tekstit dhe duke lexuar shenjat tekstore, poezitë bartin figura polisemike brenda vetë tekstit letrar. Këtë kuptim ka edhe poezia “Një vetmi një vdekje”, ku subjekti ligjërues i rikthehet vetvetes.

“Dalëngadalë thahen gjethet”

Ky është vargu që konoton të veçantën dhe të përgjithshmen e kodit tematik, sepse autori e krahason kohën me gjethen e rënë, kohë që ka shkaktuar dhembje dhe vuajtje në shpirtin e tij. Në këtë relacion autori thur edhe figuracionin e tekstit, duke përdorur vazhdimisht krahasimet. Vetmia e artikuluar vjen e shtresohet në strukturën e tekstit, duke dalë edhe si mallkim, një mallkim ky që e shpejton vdekjen. Në esencë, ky është teksti i njeriut të dëshpëruar që tani e pret vdekjen, por që lë pas vetes një vuajtje të tërë dhe një dëshpërim të tërë. Edhe poezia “Pastaj vjen trishtimi” komunikon me tekstin e parë si ide aitoriale. Pasi trishtimi jep fundin, e fundi vdekjen, ai jepet i shoqëruar me një vuajtje të madhe. Vuajtjen aitoriale e bën edhe më të fortë refreni i përsëritur “pastaj vjen trishtimi”. Në esencë ky trishtim kap një kohë të trazuar, apo më mirë të themi një kohë lufte. Subjekti paraqet një mjegullnajë ku gjërat kanë lëvizur, por edhe janë çrregulluar. Ndërsa figurat si: gjarpri, qyqja dhe ferri sjellin kobin e tmerrit të vendlindjes së vranë të autorit. Këto figura i përshtaten tekstit dhe e bëjnë më të dhimbshëm. Mirëpo, më së miri kjo dhembje del tek teksti “Poezi e vranë”, një poezi krejtësisht personale ku dhembja shprehet si dhembje personale dhe pranohet si dhembje personale. Duhet mos harruar se tërë kjo dhembje vjen si pasojë e kohës reale, pra si pasojë e luftës së fundit në Kosovë:

“Digjej dhoma ime, shtëpia ime prej guri,  
biblioteka e shpirtit”

Sipas kësaj reference tekstuale shënjohej mërzia, si proces ndjesor, e shkaktuar nga realiteti i dikurshëm, po që për subjektin ligjërues është ende e freskët dhe që ende prek shpirtërisht. Kujtesa e kohës në idenë e poetit jepet si mos harrim, kjo vërehet sidomos gjatë përshkrimit të lemerisë dhe tmerrit që ekzistonte. Ndërsa poezitë “Hapësira”, “Adresa e nëmur”, “Zëri i shpirtit”, “Mesnatë”, dhe “Bukuri e nëmur” etj., shprehin filozofinë jetësore, por çdo herë të shprehura dhe të shoqëruara me përshkrimet e vuajtjes së autorit.

Edhe vet poezia “Bukuri e nëmur”, ideja e së cilës nënkupton bukurinë e zezë, e shtyn subjektin të mallkojë në aspektin figurativ metaforik. Shenjat tekstore japin idenë se dashuria del e trishtuar, vrasëse, e mallkuar. Këtu krijohet ideja se nuk të nevojitet një send nëse është i bukur, por në brendinë e vet mban ligësinë dhe poshtërsinë. Forma nuk vlen asgjë kur brendia del bukuria e nëmur, të gjitha këto ide strukturohen nga pozicioni i një medituesi, që i jep mundësi lexuesit për komunikim me tekstin letrar. Kështu Sali Bashota sjell një tekst tejet polisemik.

**BOTOHEN NJËMBËDHJETË LIBRA UNIVERSITARË**

**Natyra e këtyre librave është orientuar në dy drejtime: në atë të shkencave politike (libra politikë-juridikë) dhe në atë të studimeve ekonomike.**

**Berat DAKAJ**



Universiteti “Victory” muajin e kaluar ka bërë promovimin e njëmbëdhjetë librave universitarë, të cilat u dedikohen studentëve të këtij Universiteti dhe çdo studenti, ose personi, që dëshiron

t'i njohë më mirë bazat e shkencave politike, njohjet drejt përpjekjeve për euroatlantizëm, leksionet e Unionit Evropian, dhe të njohë në përgjithësi çështje që kanë të bëjnë me globalizmin. Natyra e këtyre librave është orientuar në dy drejtime: në atë të shkencave politike (libra politikë-juridikë) dhe në atë të studimeve ekonomike.

Libri “Pas globalizmit” paraqitet si literaturë sipërfaqësore ndërkombëtare. Në të thuhet sistemi, dhe fusha e kërkim-studimit ecën rrugës së çështjeve ekonomike, politike, kulturore, teknologjike, etj.

Globalizmi në këtë libër definohet si: “nacion që e nënkupton botën si një tërësi të përcaktuar” dhe herë-herë ndeshemi edhe me mendime të studiuesve të tjerë për nocionet: globale, globalizëm etj., të cilat shihen si pjesë e tërësisë, e gjithësisë së botës, diçka si mbarë botërore. Mirëpo, në tërësinë e këtyre mendimeve, rreth përcaktimit sa më të saktë të globalizmit, të globales, etj, jepen mendime dhe korrigjime edhe nga autorë të mëdhenj botërorë, autorë globalë, të cilët nga pikë vështrimi i aspektit ekonomik, juridik, social, kulturor, ekologjik etj., japin përcaktimet e veta, të cilat shihen se janë të palëkundshme.

Shohim se Anthony Giddens (sociolog) e përcakton globalizmin si: “proces të grumbujve të ndërlikuar, i cili ndikon për përforcimin e marrëdhënieve shoqërore në tërë botën dhe i ndërlidh vendet e largëta, në atë mënyrë që ngjarjet lokale i kushtëzojnë ngjarjet e largëta me mijëra kilometra nga këto vende dhe anasjelltas”.

Duke e kuptuar globalizmin si energji

ndërkombëtare, si marrëdhënie shoqërore ndërmjet shteteve në lëmi të ndryshme, si shkëmbim të dukurive nga aspekte të ndryshme jetësore, atëherë mundësia e tillë e bashkëpunimit dhe komunikimit të ndërsjellë dhe metoda e punës sesi duhet vepruar për të komunikuar sa më lehtë në mënyrë ekonomike, politike, sociale, kulturore, i silltet sot lexuesit shqiptar përmes Universitetit “Viktorij”.

Libri “Leksioni i Unionit Evropian”, përpos një këndvështrimi historik të tij, themelimit të Unionit Evropian, jep vazhdimisht sinteza dhe kode të sjelljes që duhet të përfitohen për të bërë vend në Unionin Evropian. Leksioni këtu nënkupton ligjëratën e folur, e cila është lidhur me diskutim, dhe së fundi ka marrë formën e librit.

Krijimi i Unionit Evropian është emërtuar si bashkim i tri integreimeve juridike të shteteve të Evropës Perëndim-

ore: Unioni Ekonomik Evropian, Unioni Evropian për Qymyr dhe Çelik dhe Unioni Evropian për Energji Atomike. Fillea e një leksioni të tillë, pjesëmarrja në këto leksione dhe në Union, integrimet e vazhdueshme të shteteve në UE, i ka hapur perdet e saj edhe më tutje për të tërë shtetet që sot synojnë të jenë të integruara në Unionin Evropian.

Leksioni i Unionit Evropian ka një kategori të vetin, që përcakton qartë për një 60 vjeçar vendet që janë integruar në këtë sistem dhe njëkohësisht përfitimin e tyre për këtë vend.

Ky libër, përpos që është tip studimi i nivelit të lartë, ngase shumica e ligjëratave të këtij libri janë shkruar pasi kanë qenë pjesë e diskutimeve të njëpasnjëshme me studiues nga vende të ndryshme, gjithashtu jep mundësi të kuptohen shkurtesat e shteteve, organizatave, agjencive etj., e një varg teorish të tjera të panjohura në librat e mëhershëm.



Së fundi, mund të themi se ana formale dhe diskursive e librit ka kuptimin e gjuhës së fjalorit.

Në librin “Bazat e shkencës politike”, janë vënë themelet e të kuptuarit të qëllimshëm në mënyrë diplomatike.

Epigrama i dikurshme se: “politika është arti i së mundshmes”, e përforcon kuptimin edhe në këtë libër.

Baza kuptohet si nisje e diçkaje. Ndërtim mbi një themel. Themeli kryesor i shkencës është baza, ndërsa politika ndërlidhet më tërësinë e jetës shoqërore me marrëdhëniet e brendshme e të jashtme të shtetit.

Shteti-pushteti, sistemi politik, zgjidhja rationale, institucionet e shtetit, detyrat kufizimet, partitë, sistemi i partive. Të gjitha këto përbëjnë një qasje të nevojshme dhe të detyrueshme ndaj shtetit dhe ndaj pushtetit, madje edhe relacionet e popullit (individit) me tërësinë shtetërore, janë dhënë në këtë libër si projekte politike për ta bërë sa më të lehtë këmbimin e informacionit të qytetarit dhe qeveritarit.

Edhe libri “Marrëdhëniet politike ndërkombëtare” me librin tjetër të titulluar “Euroatlantizmi”, shtjellohen secili prej tyre nga aspekti i studimit të lëvizjeve të mëdha dhe të reja ndërkombëtare. Vëzhgimet dhe pikëtakimet e rrymave të ndryshme politike e ngritin vlerën e këtyre dy librave, tek të cilët planifikimi i metodologjisë shkon drejt prirejve themelore për subjekte sa më të forta dhe të qëndrueshme ndërkombëtare. Të dy këta libra mund të kategorizohen në libra të veçantë studimi për shumë arsye. E para, baza e tyre nisët nga çështjet themelore, siç janë:

1. Një pasqyrë sipërfaqësore mbi zhvillimin historik të marrëdhënieve ndërkombëtare;
2. Metodologji dhe qasje shkencore ndaj problemeve ndërkombëtare;
3. Pikëpamje teorike, modalo-politike të udhëheqjes;
4. Tipa të marrëdhënieve ndërkombëtare, etj.

Pavarësisht nga këto çështje të mëdha politike, Universiteti “Victory”, për t’i ofruar shërbime më të mira dhe libra sa më të mirë studentëve të vet që marrin dije në atë institucion, iu ka ofruar mundësi studimi më të mira përmes literaturës së huaj ekonomike nga gjuha slllovene, kroate në atë shqipe.

Të kësaj natyre shkencore janë edhe librat: “Bazat e Ekonomisë”; “Bazat e së drejtës tregtare statusore dhe kontraktore”; “Kontrollingu”; “Informatika afariste për

ekonomistë”; “Doracak matematiko-statistikor për sipërmarrës”; “Teknologjia e informacionit në afarizëm”.

Librat janë përkthyer nga kroatishtja, slllovenishtja. Botues në shqip - Kolegji Universitar “Victory”, Prishtinë.

Autorët - përkthyesit:

1. Jasna Plevnik: “Pas globalizimit-Gjeoekonomia e marrëdhënieve ndërkombëtare”, përkthyes Hajrush Podvorica.



2. Vlatko Mileta: “Leksioni i Unionit Evropian”, përkthyes Nebi Islami.

3. Lidija Cehuliq: “Euroatlantizmi”, përktheu nga kroatishtja, Mustafë Reçica.



4. Donatela Della Porta: “Bazat e shkencës politike”, përktheu nga slllovenishtja, Nikollë Berishaj.

5. Radovan Vukadinovic: “Marrëdhëniet politike ndërkombëtare”, përktheu nga kroatishtja, Sabri Mehmeti.



6. Svetislav Polovina Gjuro Sh. Mediq: “Bazat e Ekonomisë (Doracak për studimin e ekonomisë me tekstin e P. Samuelson W. Nordhaus “Ekonomia”, përkthyes Musli Imeri.

7. Vilim Gorenc: “Bazat e së drejtës tregtare statusore dhe kontraktore”, përkthyes Milazim Mulolli.



8. Dr. sc. Nixhara Osmanagic Bedenik: “Kontrollingu - ABËCË-ja e suksesit afarist”, përkthyes Ferid Teliqi.

9. Millan Vukiceviq Millan Papiq: “Doracak matematiko-statistikor për sipërmarrës”, përkthyes Zenun Rexhepi.

10. Dr. Zhelko Panian: “Informatika



afariste për ekonomistë”, përkthyes Osman Abdullahu.

11. Vlatko Çeriq Mladen Varga: “Teknologjia e informacionit në afarizëm”, Hysen Kadriu.



Poezi

## DASHURIA QË VRET

Valmira PEÇI

### ZONA E SIGURISË

Po dridhet toka  
Shpirti im  
Nga telat me gjemba  
S'kam frymë  
Po rrënohet ura  
Në mes nesh  
Kepi i Shpresës së Mirë  
Po vdes  
Për dashurinë  
Zonë rreziku  
Ne në mes

### HIPOKRIT I LAGUR

Parfume të zeza grash qelben në ty,  
Lypës i zi, mendjendrituri tepër,  
Pjellë në teatër si kryevepër,  
Qaj e qesh për maskën e shkrirë mbi sy.

Qaj për mjerimin tënd si endacak  
Rrugëve me shi maska e përlyer,  
Qeshu me veten, hipokrit i përkryer,  
Përjetësisht emri yt është dështak.

Virgjëreshë e trëndafiltë zihet  
Ecejakeve të errëta të hipokrizisë,  
Ti nuk njeh nektarin e dashurisë.

Mendjemadh i uritur duarshtirë,  
Dekorata të maskuara mirë,  
Ti, krimb i kërleshtë i shoqërisë.

### DASHURIA QË VRET

Kam frikë pluhurin e kuq  
Zjarr e akull  
Nektari i luleve t'majit  
Deh shqisat  
Nga dashuria që vret

Kam frikë kohën pa mend  
Ag e muzg  
Verbëruar nga sytë  
Puth errësirën  
E dashurisë që vret

Kam frikë letrën e bardhë  
Himn e elegji  
Në festivale dashurie  
Vajton mallin e sertë  
Për dashurinë që vret

Kam frikë mëkatin nuse  
Jetë e vdekje  
Nga lufta me njeriun  
Bota është sëmure  
Prej dashurisë që vret

Kam frikë shpirtin fëmijë  
Parajsë e ferr  
Freskon e djeg  
Lëkurën shpirtërore  
Dashuria që vret

### SHESHI “NËNË TEREZA”

Ta ujita bustin  
Me lotët e mi  
Humba gjelbërimin  
Natën plot mjegull  
Plot trishtim  
Plot vdekje

Zonjë e Madhe  
Më jep pak humanizëm  
Shtigjeve me hithra  
Zbathur shprese  
Zhveshur besimi  
Lutem në shesh  
Për ne të dy  
Më jep pak humanizëm  
Për dhembjen  
Jetës i përkulem  
Më jep vdekjen  
Merre dashurinë

### BULEVARDI “BILL CLINTON”

Nëpër vijat e bardha  
Shkele shpirtin  
Godite mendjen  
Udhëkryqeve gri  
Ëndrra parkohet qiellit  
Mit bëhet ndjenja  
Para semaforit të kuq  
Dashuria u nxi  
Në Bulevardin e Paqes  
Shpalle Luftën e Përjetshme  
Bulevardi mbeti pa emër  
Ne pa dashuri



Mjekësi

## TRASHËSIA (OBESITAS) DHE KONTROLLIMI I PESHËS

“Ushqimi i përgatitur për dy, është i mjaftueshëm për tre, ...”


Agron REXHEPI

Trashësia (obesitas) është një gjendje patologjike kronike e organizmit që definohet si akumulim (grumbullim) i tepërt i indit dhjamor në trup. Kjo gjendje duhet të llogaritet dhe të trajtohet si një sëmundje kronike, që bart në vete rrezik të madh për funksionimin normal të sistemit kardiovaskular. Shumë lehtë mund të ndodhë që sasia e tepërt e dhjamit (në çfarëdo sasive qoftë) të bëhet një armë e rrezikshme në trupin e njeriut. Një trashësi me përmasa, fjala vjen 15 kg mbi peshën normale, do të shkaktonte probleme të shumta shëndetësore (sëmundje të zemrës, shtypje të lartë të gjakut, tumore, etj). Humbja e peshës së tepërt te personat e trashë përmirëson shëndetin e tyre në mënyrë sinjifikative. Në të shumtën e rasteve trashësia fillon që në fëmijëri. Fëmijët e prindërve të trashë kanë gjasa dy deri në tri herë më të mëdha për trashësi (obesitet) në krahasim me fëmijët e prindërve jo të trashë. Trashësia mund të shkaktohet si pasojë e faktorëve gjenetikë (25-30% të rasteve), ushqimit jo të shëndoshë, shprehisë për të konsumuar sasi të madhe të ushqimit dhe

faktorëve patologjikë. Sasia e tepërt e yndyrës gjithashtu mund të grumbullohet “qetë dhe ngadalë” edhe në moshën madhore, ku duhet veçuar të ashtuquajturën “moshë të rrezikuar” 25 deri në 44 vjeçare (sidomos moshë mbi 35 vite), ku në favor të trashësisë veprojnë faktorë të ndryshëm (si faktorët hormonal, rënia e aftësive funksionale, zvogëlimi i ritmit të jetës, etj). Është menduar se konsumimi i ushqimit të tepërt është faktori kryesor i trashjes (kur merren më tepër kalori se sa shpenzohen dhe se kaloritet e tepërta deponohen në formë të lipideve në indin dhjamor). Sikur kjo të ishte kaq e thjeshtë, atëherë sigurisht se edhe problemi i trashësisë së tepërt (obesitetit) do të eliminohej relativisht lehtë, me zvogëlimin e konsumimit të ushqimit. Mirëpo, përveç faktorit të konsumimit të tepërt të ushqimit, janë edhe disa faktorë të tjerë që favorizojnë, respektivisht ndikojnë në shkaktimin e trashjes, siç janë faktorët gjenetikë, social, psikologjikë, ambientit, çrregullimet hormonale, niveli i metabolizmit bazal, temperatura

bazale e trupit, niveli i aktivitetit spontan, nivelet e adenozinë trefosfazës qelizore, lipoprotein lipazës dhe enzimeve të tjera. E gjithë kjo dëshmon etiologjinë multikauzale të trashësisë, fakt ky që në një masë të konsideruar e vështirëson shërimin e kësaj gjendje të rëndë patologjike, e cila shumë qetë, por sigurt, e dëmton shëndetin dhe e rrezikon jetën. Hulumtimet statistikore të bëra dëshmojnë se, trashësia (obesiteti) nga dita në ditë po merr përmasa epidemiologjike. Meqenëse te ne nuk ka të dhëna statistikore që do të na tregonin për përmasat e trashësisë në popullatën tonë, duhet të shërbehemi me të dhënat e vendeve të tjera. P.sh. ndërmjet 30-35% të të rriturve amerikanë (femra dhe meshkuj) peshojnë së paku 20% më tepër se sa që ishte dashur të peshonin normalisht, ndërkaq, 15 milion njerëz nga po ky grup janë shumë të trashë dhe të rrezikuar seriozisht nga sëmundjet e ndryshme si pasojë e trashësisë. Për përmasat dhe seriozitetin e këtij problemi flet edhe fakti se të paktën 50 milionë qytetarë amerikanë mbajnë në kurrizin e

### % e indit dhjamor nënlëkuror dhe mirëqenja e organizmit



tyre gati gjysmë miliardi kilogramë peshë të tepërt. Shembull tjetër që flet për përmasat epidemiologjike të kësaj sëmundje në SH.B.A. është edhe rasti i një stadiumi të futbollit amerikan, ku pas ndërrimit të ulëseve të “vjetra dhe të vogla” me ulëse “më të reja dhe më të mëdha” për njerëz më të “mëdhenj” (më të trashë) numri i ulëseve të përgjithshme është zvogëluar për 9000.

Ky është realiteti i sotshëm: “Përderisa në disa vende të botës popullata vdes nga uria, në vendet e tjera popullata rrezikohet nga ushqimi i tepërt.” Sipas disa hulumtimeve të bëra nga Universiteti i Harvardit është vërejtur se ekziston korrelacion pozitiv ndërmjet trashësisë (obesitetit) te adoleshentët (mosha 13-18 vjeçare) dhe keqësimit të shëndetit 55 vite më vonë. Kështu që nëse ndikohet me kohë në zvogëlimin e problemit të trashësisë do të mund të ndikohet edhe në zvogëlimin e përqindjes së morbiditetit sëmundshmërisë së popullatës. Personat

sëmundjet mushkërore dhe rënia e funksionit respirator, në përgjithësi, për shkak të vështirësisë së lëvizjes së kafazit të kraharorit gjatë frymëmarrjes;

Problemet e udhëheqjes së anestezionit gjatë ndërhyrjeve kirurgjikale; osteoarthritis-i dhe sëmundjet e tjera degjenerative të nyjëtimeve; disa lloje të sëmundjeve kanceroze; vlerat jo normale të lipideve dhe lipoproteineve në plazmë; çrregullimet menstruale; ngarkesa e madhe psikike.

Disa hulumtime shkencore kanë treguar se mbipeshja është një nga 34 shkaqet më kryesore që shkaktojnë sëmundjet e zemrës. Humbja e peshës te personat e trashë shpeshherë ndikon në zvogëlimin e kolesterolit dhe të triglicerideve në serum, si dhe ka ndikim të mirë në uljen e tensionit arterial. Në hulumtime të shumta është vërejtur se ka korrelacion pozitiv ndërmjet moshës dhe shtypjes së gjakut. Kjo lidhshmëri mund të shpjegohet me faktin se me rritjen e

sëmundjeve të tjera.

Në bazë të formës së grumbullimit të masës së tepërt yndyrore, dallojmë dy lloje të trashësisë (obesitas):

Lloji qendror, apo android, i trashësisë haset më tepër te meshkujt. Masa e tepërt yndyrore është e shpërndarë në pjesën e sipërme të trupit. Kjo formë e shpërndarjes së masës së tepërt yndyrore është më e rrezikshme për shëndetin dhe vjen si pasojë e stimulimit neuro-hormonal;

Lloji periferik apo gynoid i trashësisë haset më tepër te femrat. Masa e tepërt yndyrore është e përhapur në pjesën gluteale, abdominale dhe femorale. Kjo formë e shpërndarjes së masës së tepërt yndyrore është më pak e rrezikshme për shëndetin krahasuar me formën e mësipërme.

Zvogëlimi i mbipeshës dhe largimi i masës së tepërt yndyrore me aktivitete fizike dhe dietë është më i suksesshëm në tipin qendror (android), se sa në tipin periferik (gynoid) të trashësisë.

Klasifikimi tjetër i mbipeshës trupore me karakter yndyror është i bazuar në madhësinë dhe numrin e qelizave yndyrore adipocytes.

Para moshës madhore indi dhjamor i trupit shtohet në dy mënyra: Duke u rritur qelizat dhjamore (adipocitet), pra kur kemi të bëjmë me procesin e hipertrofisë; me shtimin e numrit të qelizave yndyrore (adipociteve) apo me procesin e hiperplazisë.

Numri i adipociteve stabilizohet para moshës madhore. Kështu që, shtimi i masës yndyrore në moshën madhore vjen, kryesisht, si rezultat i hipertrofisë së adipociteve.


### Si të humbet pesha e tepërt?

Të ushqehemi qetë, më ngadalë dhe ta hamë ushqimin me kafshata të vogla. Meqenëse akti i përtypjes çon sinjale në qendrën për ngopje në sistemin nervor qendror, atëherë preferohet që një kafshatë ushqimi të përtypet të paktën për 20 sekonda, apo 3036 herë;

Të mos harrojmë se për afërsisht 20 minuta pas ndërprerjes së ushqimit mund ta ndjejmë veten se jemi të ngopur apo jo;

Të konsumohen sa më shumë gjëra të forta (psh. mollët) dhe sa më pak gjëra të buta (psh. bananet).

Ruajtja e ekuilibrit të ushqimit (kur marrja e kalorive përmes ushqimit është e barabartë me shpenzimin e tyre) çon në mbajtjen e peshës së arritur trupore. Ndërkaq, prishja e këtij ekuilibri, varësisht se a do të jetë pozitiv apo negativ, çon në rritjen, respektivisht, në zvogëlimin e peshës trupore. Në rastet e mbipeshës është me rëndësi realizimi i



e trashë, me masë të tepërt të indit dhjamor (obesitas), me kalimin e kohës, më së shumti rrezikohen nga këto sëmundje:

Insuficiencia (pamjaftueshmëria) kardi-ake (sidomos e zemrës së majtë), si rezultat i punës së rritur të zemrës; hipertensioni dhe infarkti i zemrës; diabeti (më se 80% të pacientëve që vuajnë nga sëmundja e sheqerit kanë mbipeshë trupore); sëmundjet veshkore;

moshës shtohet edhe pesha, ndërkaq me shtimin e peshës së tepërt rritet shtypja e gjakut. Te të rriturit diagnostikimi i mbipeshës (trashësisë) me karakter dhjamor bëhet në se masa dhjamore e kalon 20% të masës së përgjithshme trupore te meshkujt, dhe 30% te femrat. Ndërkaq, në rastet kur këto vlera mbërrijnë në 80% te femrat, dhe 95% te meshkujt atëherë rritet rreziku i vdekjes nga sëmundjet e arterieve koronare dhe

mosbalancimit negativ të ekuilibrit të ushqimit (mosbalancimi negativ energjetik).

Ekzistojnë tri mënyra për arritjen e prishjes së ekuilibrit të energjisë, në drejtim të humbjes së peshës trupore:

Zvogëlimi i kalorive ditore të konsumuara përmes ushqimit; marrja normale e kalorive përmes ushqimit dhe rritja e shpenzimit të tyre (rritja e aktiviteteve fizike); kombinimi i dy metodave të mësipërme; zvogëlimi i marrjes së kalorive përmes ushqimit dhe rritja e



shpenzimit të tyre.

Metoda e parë, zvogëlimi i kalorive ditore të konsumuara përmes ushqimit apo dieta në ushqim, është provuar eksperimentalisht në të gjitha format e saja: abstenimi në ushqim, dieta në karbohidrate, dieta në lipide dhe dieta në proteina. Rezultati përfundimtar ka qenë: humbje shumë e ngadalshme dhe e pakontrolluar e peshës (në disa raste humbje e masës muskulore) si dhe shpeshherë paraqitje e dukurive të ndryshme patologjike.

Edhe metoda e dytë nuk është treguar shumë efektive, për dy arsye: e para, me fillimin e aktiviteteve fizike, në të shumtën e rasteve shtohet edhe oreksi për ushqim, dhe e dyta, vetvetiu aktivitetet fizike me të cilat fillojnë të merren personat me mbipeshë trupore nuk karakterizohen me shpenzim të madh të kalorive ditore (apo javore).

Metoda ideale për humbjen e peshës së tepërt trupore (masës së tepërt të indit dhjamor) është ajo e treta, kombinimi i metodës së parë (zvogëlimi i marrjes së kalorive përmes ushqimit) dhe metodës së dytë (rritja e shpenzimit të kalorive). Për personat mesatarisht të trashë dhe për të rriturit, kombinimi i aktiviteteve fizike aerobe dhe dietës në ushqim (relativisht më shumë karbohidrate dhe më pak lipide) ofron mundësinë e arritjes së bilancit kalorik negativ. Gjithsesi, me vetë disiplinë në mbajtjen e dietës në ushqim dhe në realizimin e programit të aktiviteteve fizike (stërvitjeve), qëllimi duhet të arrihet në mënyrë progresive. Në

rast se lajmërohen lëkundjet e shpeshta të peshës trupore (herë rritje dhe herë zbritje), apo mos humbja e dëshiruar e peshës së tepërt, duhet kërkuar se ku është bërë gabimi: në mos zbatimin e dietës, në përpilimin e programit joadekuat të aktiviteteve fizike apo në mos zbatimin e rregullt të tij.

Ndërkaq, për një sukses më të mirë të dietës është mjaft me rëndësi që vetë personi që dëshiron të pakësojë peshën trupore të vetëdijësohet dhe të zhvillojë një frikë nga pesha e tepërt trupore (kjo do t'i ndihmonte të jetë më i qëndrueshëm në dietë). Çdo njeri duhet të vetëdijësohet se masa e tepërt e indit dhjamor, në çfarëdo sasive qoftë, me kohë do të bëhet armë e rrezikshme në trupin e tij, shkaktare e shumë sëmundjeve të rënda (të cekura më lart) dhe vdekjeprurëse.

Aktivitetet fizike ndikojnë edhe në zbritjen e vlerave të rritura të lipoprotein kolesterolit. Për personat me mbipeshë trupore që kanë kaluar një jetë fizikisht pasive, është me rëndësi që aktivitetet fizike t'i fillojnë në natyrë dhe ngadalë, jo të hyjnë menjëherë në aktivitete fizike të nivelit të lartë. Në fazën fillestare duhet bërë një përgatitje psikike dhe fizike e personave me mbipeshë trupore, që qëllimi i tyre do të arrihet me kohë, të zhvillojnë vetë disiplinën dhe të zbatojnë me përpikëri planin e dietës dhe të aktiviteteve fizike. Gjatë disa javëve të para (apo muajve), ecja e ngadalshme duhet të zëvendësohet me ecje të shpejtë, e cila herë pas here duhet të kalojë dhe të vazhdojë në vrapim (të lehtë). Si formë e aktivitetit fizik preferohet ecja e shpejtë, vrapimi, çiklizmi, por e një rëndësie të veçantë janë lojërat rekreative. Efikasiteti i aktiviteteve fizike në humbjen peshës së tepërt varet nga frekuenca, intensiteti, kohëzgjatja dhe koha e zbatimit të tyre.

Sa i përket frekuencës së aktiviteteve fizike, ajo së paku duhet të jetë 3 herë në javë, por për një ndikim më efikas në kompozicionin e trupit është e preferuar që aktivitetet fizike të bëhen 5 herë në javë;

Intensiteti i aktiviteteve fizike për humbjen e mbipeshës trupore (masës yndyrore) përcaktohet në mënyrë individuale, por gjithnjë duke pasur parasysh atë nivel të punës fizike, kur si burim energjie shfrytëzohen kryesisht yndyrat (40-60% të VO<sub>2</sub> max);

Kohëzgjatja e aktiviteteve fizike duhet të jetë nga 30 minuta deri 60 minuta e më shumë, varësisht nga lloji dhe intensiteti i aktivitetit fizik;


Ndërkaq, me qëllim të zbritjes së peshës trupore, apo ruajtjes së peshës "ideale",

preferohet që aktivitetet fizike të bëhen në orët e pasdites, menjëherë para darkës, sepse me këtë pakësohet oreksi.

Një fakt tjetër me rëndësi për ndikimin e aktiviteteve fizike të zhvilluara në orët e vonshme të pasdites, në humbjen e peshës së tepërt, është edhe ndryshimi i nivelit të metabolizmit gjatë ditës. Përderisa gjatë ditës kemi rritje të metabolizmit të organizmit, në kohën e darkës kemi rënie të metabolizmit dhe zvogëlim të shpenzimit të kalorive të përgjithshme. Me zhvillimin e aktiviteteve fizike në këtë kohë, përveç ndikimit në zbritjen e oreksit, ndikohet edhe në rritjen e metabolizmit, rritjen e kalorive të shpenzuara (të djegura), si dhe në pakësimin e indit dhjamor (normal nëse aktivitetet fizike janë të shoqëruara me dietën në ushqim zvogëlimi i kalorive të konsumuara).

Në mënyrë të përgjithshme, kërkohet që në çdo seancë të aktivitetit fizik të shpenzohen së paku 300 kcal. Është e një rëndësie parësore të kalkulohet sasia e kilo kalorive të konsumuara dhe kilo kalorive të shpenzuara, si dhe që përmes realizimit të programit për zvogëlimin e mbipeshës trupore të ndikohet në pakësimin e indit dhjamor, e jo vetëm të kilogramëve truporë.

Humbja e peshës në ditët e para të tretmanit (aktivitetet fizike të kombinuara me dietë në ushqim) është fillimisht rezultat i humbjes së ujit të lidhur me glikogjenin në organizëm (1 gram glikogjen në muskuj i lidh 3 gram ujë).



Me vazhdimin e mëturjeshëm të tretmanit, humbja e peshës do të thotë edhe humbje e masës yndyrore.

Për realizimin e qëllimit përfundimtar (humbja e peshës së tepërt), përveç aplikimit të kësaj metode të kombinuar, duhet të ndryshohet edhe stili ditor i jetës (aty ku ka mundësi, në vend të automobil të përdoret biçikleta, apo të ecet në këmbë; në vend të ashensorit të shfrytëzohen shkallët, etj.).

## LAJME NGA TEKNOLOGJIA

### Shkelzen NUZA

#### Telefonat Mobil me Wi-Fi

Nokia 6136 është mobil që T-Mobile po përdor për shërbimet e tij Wi-Fi. Shërbimi i cili është më i lirë se sa telefonat tjerë tradicional, këta telefona janë aktiv vetëm në Seattle të SHBA ve. Sidoqoftë, T-Mobile shpreson të shpërndajë rrjetin në tërë vendin. (Nokia)




Samsung SGH-T709 punon në Wi-Fi ose si njihet ndryshe edhe si rrjeti celular. Është njëri prej dy telefonave që T-Mobile po e ofron për shërbimet e tij Wi-Fi në Seattle. (Samsung)



#### Ekzistenca e ujit në Mars

Krahasimet e bëra nga Mars Global Surveyor gjatë viteve 2001 dhe 2005 tregojnë zbehje të ngjyrës që ndryshon në një pjerrësi për të cilën shkencëtarët besojnë që mund të ndikojnë në rrjedhjen e shkurtër të ujit. (NASA/JPL/Malin Space Science Systems)



#### Një maus plotësues për botën 3D

Një pajisje e re periferike ndihmëse prej Logitech 3D Connexion i mundëson shfrytëzuesve një vegël shtesë për navigim 3D. Pajisja quhet SpaceNavigator, e cila lidhet me PC nëpërmjet portit USB. Duke përdorur gjashtë senzore optik, navigatori 3D nuk është zëvendësim për maus por është i menduar për shfrytëzim për dorën e lire. Pajisja ishte zhvilluar në bashkëpunim me Google, kështu që ky mund të punojë lirshëm me Google Earth. 3D Connexion do të ofrojë një version personal me mbështetje online të SpaceNavigator PE--për \$49, dhe një version profesional me përkrahje online të email-it dhe telefonit për \$99. (Logitech)




#### Intel quad- çipi del në treg para kohe

Produktet Xeon më të reja të Intelit, quad-core 5335, kushton \$690 në sasi prej 1,000 copë.



Ky ilustrim tregon të dy çipat dual-core brenda pakos Xeon 5335. Secili çip ka një procesor të Xeon 5100 "Woodcrest".



Intel ka lëshuar në treg quad-core Xeon 5335 më 11 Dhjetor 2006. Në këtë foto tregohet fillimi dhe fundi i këtij procesori, i cili përfshin dy çipa dual core të montuar në pako të vetme. (Intel)



## POEZI HUMORISTIKE

Ilir DESKU

### HIMNI I FLAMURIT

Rreth korrupsionit të përbashkuar  
Me një dëshirë e një qëllim  
Të pasurohemi sa të mundemi  
Të vjedhim deri në pambarim

Prej korrupsionit do të largohet  
veç ai që është trim e bujar  
Në kohë të sotit po s'u korruptove  
nuk mund të bëhesh dot kryetar


Se qeveria vet e tha me gojë  
Se tenderet shuhen përmbi dhe  
Po korrupsioni do të rrojë  
Për të pandalë luftojmë ne

E ne, në dorë armët do t'i mbajmë  
Ta mbrojmë atdheun anë e kënd  
Se korrupsioni nuk po zhduket  
Ai është sot në çdo vend.



### RINIA JONË

Oj rini sa je e bukur  
Aq e bukur sikur flutur  
Ia kanë mësy të gjithë Evropës  
Sikur tretet uji prej gropës  
Prej KOSOVËS duan me shku  
Se s'po kanë ku me punu  
Po të shkretët hiç nuk kanë faj  
Po e hanë bukën veç me çaj  
Në mundshin do letra me i rregullu  
Me ndonjë auslanderk me u martu  
Kështu ka bërë një herë vaki  
Shkoj SAHITI në Gjermani  
Me një gjermankë ai u martu  
Letrat fill i pat fitu  
Bani ker e limuzinë  
Fill e ndërtoi edhe shtëpinë  
Filloi para me ju dërgu  
Hambarin me e rregullu  
Ju dërgonte para për çdo vjet  
Gjer sa e banën mirë një buxhet  
Shumë të shtëpia ata e dojshin  
T'gjitha të mirat ia urojshin  
E RRUSTEMI vllau i tij  
U bo bos, e u bo mafi  
Nja pesë lokale i pat ndërtue  
Me qira i kish pas lëshue  
Shumë e donte SAHITIN vlla  
Po e përmend çdo natë sa s'ka  
Çdo ditë e thirrte në telefon  
Çka i ke punët baca jonë  
Po kur nisi me u mplak  
S'kish fuqi ma e as takat  
Në pension ai kish dal  
Edhe parat tash ua kish ndalë  
S'iu dërgonte para sikur për vjet  
Po një herë në dy tri vjet  
E RRUSTEMIT i pat mbet hatri  
Veç sa s'qante nga inati  
Ma nuk e kujtonte si për natë  
Se s' kish interes më ai i ngratë  
As telefonin s'ia pat cingërrue  
Se nuk kish më pare me ju dërgue  
Kështu pat bërë njëherë vaki  
U mplak SAHITI në Gjermani  
Kjo histori kështu pat përfundue  
Në paçi mund me e kuptue.

	1	2	3	4	5	6	7	8	9	10	11	12	13	14						
1			■					■					■							
2									■		■									
3																				
4		■		■				■			■									
5						■	■													
6	■											■								
7	■																			
8																		■		
9		■	■																	■
10			■																	
11																				
12																				
13				■																■
14																				
15		■																	■	
16			■																■	
17													■							
18				■		■						■								
19							■	■			■		■							
20		■	■					■		■										

## HORIZONTALISHT

1. LE-Sëmundje e rëndë ngjitëse-Këngëtarja Bajrami-Italia. 2. Perandorak (ang.)-Oseti-Ministria e Postës dhe Telekomunikacionit. 3. Kryenegociatori për statusin e Kosovës në foto. 4. Zanore-Oksigjen-Dante Aligeri-Që katë bëjë me rininë-Jo (fr.). 5. I mençur-Këngëtarja Tuda. 6. Bisedime për të arritur deri te një marrëveshje-Thaj. 7. Kaptinë (Sure) për kohën-Qytet i shenjtë i muslimanëve. 8. Institute-Amerika-Targat e Tiranës. 9. Kalium-Kampion-Shkronjë greke. 10. SR-Zanorja jonë e katërt - ... dhe mbiemri. 11. T.I.N.O-Ekip futbollistik në Spanjë...Madrid. 12. E.T.E.N-I.L.T.U. 13. Smirë-Përemër vektor-M. 14. I.T.T.I-Konop (sh.). 15. Telekom-Pjesëmarrës i gjallë në veprimtarinë e një organizate (sh.)-nyje në anglisht. 16. Ose (ang.)-Ajo që sundon përkohësisht kur mungon mbreti-shok (fr.). 17. Formë e shprehjes së mendimit të popullit për një çështje shtetërore e shoqërore me rëndësi të veçantë (sh.)-Sulfur. 18. I.H.E-Spanja-Marr frymë shpesh e me vështirësi-T.T. 19. Përçues i lidhur me radion, televizionin që shërben për të kapur apo përhapur valë elektromagnetike-Instant Messenger-Nota e dytë e shkallës muzikore. 20. Litri-Emër femre-A-Boksieri ynë Krasniqi.

## VERTIKALISHT

1. Port-Që gëzon të drejtën për të mos iu nënshtruar ligjeve të shtetit të huaj. 2. Këngëtarja Qazimi-Ish sekretari i OKB-së, Kofi-Ceremonitë fetare Komisioneri i Evropës për zgjerim Oli. 3. Kundërshtim i vendosur për një padrejtësi a për një veprim të paligjshëm (sh.)-Futbollist italian Alessandro-Profesor në fakultetin Filologjik, Mehdiu. 4. Komplet (ang.)-Sulm i armatosur i një shteti kundër një shteti për t'i pushtuar tokat e për ta nënshtruar-Lexo (ar.)-Edi Rama. 5. Flori-Shkronjë greke-Hapësirë gjeografike (sh.). 6. Kryeqyteti i Arabisë Saudite-Karbon-I.G.J.E-A.N. 7. Sulmues në Man United Hapësirë a sipërfaqe tokësore-A. 8. Language Technology-Nota e katërt muzikore-Vend në Afrikë. 9. A-Ngacmoj-Erë e vullshme dhe e shpejtë (sh.). 10. Emër femre-Aq sa duhet, as më shumë e as më pak. 11. Ton e Azot-Çdo send që përdoret si lëndë e parë për të prodhuar për qëllime të caktuara (sh.)-edhe (lat.)-litër. 12. Një gjë që ia lëmë dikujt për ta ruajtur (sh.)-Emër i huaj femre-Kalë shale-Radius e uran. 13. Formë e varësisë së një shteti nga një shtet tjetër më i madh-Posedoj-Çaj (ang.). 14. Rrugëtim-Përfaqësues i rrymës iluministe - Përdoret në vend të emrit të vërtetë të diçkaje që nuk duam ta përmendim.